



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 43

Tiranë – E enjte, 18 mars 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 31/2021, datë 8.3.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut..... 5051
Dekret i Presidentit nr. 12016, datë 11.3.2021	Për shpallje ligji..... 5080
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 140, datë 10.3.2021	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Tiranës..... 5080
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 10.3.2021	Për përcaktimin e kriterëve për përfituesit nga programi për zhvillimin e zonës, me qëllim strehimin, mënyrën e sigurimit të strehimit të tyre gjatë periudhës së ndërtimit, formën e kalimit të pronësisë për kuota të përcaktuara për banesa sociale nga ndërtuesit ose pronarët, për strehimin e përfituesve që janë zhvendosur prej tyre..... 5080
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 146, datë 10.3.2021	Për krijimin, organizimin, dhe funksionimin e Muzeut të Arsimit Korçë..... 5083
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.168, datë 17.3.2021	Për kalimin në pronësi të bashkive Vorë dhe Shijak të objekteve arsimore, kopshti “Muçaj”, bashkia Vorë, kopshti nr.1 dhe shkolla e mesme “16 shtatori”, bashkia Shijak..... 5085
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.169, datë 17.3.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objekteve të ish-repartit “Renea”, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Linzë, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si njësi zbatuese..... 5086
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 170, datë 17.3.2021	Për një ndryshim në vendimin nr.7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe procedurën për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit” 5086

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 54, datë 22.2.2021	Mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	5087
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 55, datë 22.2.2021	Mbi licencimin e shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Guri i Zi”, me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC “Daznjanë” me kapacitet të instaluar 1518 kw, dhe HEC “Shëlli”, me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw.....	5088
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 56, datë 22.2.2021	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Rei – Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Lingjaca 1”, me kapacitet të instaluar 1897 kw, HEC “Lingjaca 2”, me kapacitet të instaluar 300 kw, me kapacitet total të instaluar 2197 kw.....	5090
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 57, datë 22.2.2021	Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për vendosje hipoteke dhe barrë sigurorese/peng, në favor të Bankës Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k.....	5092
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 58, datë 22.2.2021	Mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari”, me kapacitet të instaluar 1972 kw.....	5093



LIGJ
Nr. 31/2021

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË PARTNERITETIT, TREGTISË
DHE BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
MBRETËRISË SË BASHKUAR TË
BRITANISË SË MADHE
DHE IRLANDËS SË VERIUT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, e cila i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 8.3.2021

**Shpallur me dekretin nr. 12016, datë 11.3.2021
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Ilir Meta**

**MARRËVESHJE PARTNERITETI,
TREGTIE DHE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË
BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE
DHE IRLANDËS SË VERIUT**

Republika e Shqipërisë (“Shqipëria”) dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (“Mbretëria e Bashkuar”) (më poshtë “Palët”),

duke ditur, që Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit midis Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve

Anëtare të tyre, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, e nënshkruar në Luksemburg, më 12 qershor 2006 (“Marrëveshja BE–Shqipëri”) do të pushojë së zbatuari për Mbretërinë e Bashkuar në fund të marrëveshjes për periudhën tranzitore, periudhë gjatë së cilës kjo Marrëveshje vazhdon të zbatohet për Mbretërinë e Bashkuar;

duke marrë parasysh parimet e përcaktuara në preambulën e Marrëveshjes BE–Shqipëri, dhe duke dëshiruar që të drejtat dhe detyrimet midis Palëve, siç parashikohet nga Marrëveshja BE–Shqipëri, të vazhdojnë siç modifikohen në këtë Marrëveshje;

bien dakord si më poshtë vijon:

**Neni 1
Objekti**

1. Objekti kryesor i kësaj Marrëveshjeje është të ruajë marrëdhëniet midis Palëve të krijuara nga lidhja e përcaktuar në nenin 1 të Marrëveshjes BE–Shqipëri.

2. Në veçanti, Palët bien dakord të ruajnë kushtet preferenciale në lidhje me tregtinë midis Palëve, që rrjedh nga Marrëveshja BE–Shqipëri dhe të sigurojnë një platformë për liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë ndërmjet Palëve.

3. Për shmangien e dyshimit konfirmohet që Palët krijojnë një bashkëpunim, si dhe një zonë të tregtisë së lirë të mallrave dhe rregullave shoqëruese, në përputhje me këtë Marrëveshje dhe afirmojnë objektivat në nenin 1 të Marrëveshjes BE–Shqipëri (të modifikuar nga ky instrument).

**Neni 2
Përkufizimet dhe interpretimi**

1. Ky “instrument” nënkupton nenet nga 1 deri në 12 dhe shtojcat nga I deri në III më poshtë, së bashku me preambulën e mësipërme dhe nënshkrimet më poshtë.

2. Në të gjithë këtë instrument:

“Marrëveshja e Inkorporuar” nënkupton dispozitat e Marrëveshjes BE–Shqipëri në masën e përfshirë në këtë Marrëveshje (dhe shprehjet përkatëse duhet të lexohen në përputhje me të); dhe

“*Mutatis mutandis*” nënkupton ndryshimet teknike të nevojshme për të zbatuar Marrëveshjen BE–Shqipëri, sikur ajo të ishte lidhur midis



Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, duke marrë parasysh objektin dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

3. Përgjatë Marrëveshjes së Inkorporuar dhe këtij instrumenti, “kjo Marrëveshje” nënkupton të gjithë marrëveshjen që përfshin këtë instrument dhe pjesët përbërëse të kësaj Marrëveshjeje, siç specifikohet në nenin 10 të këtij instrumenti dhe dispozitat e Marrëveshjes BE–Shqipëri, siç përfshihet në nenin 3(1).

4. Referencat ndaj bashkëpunimit financiar në Marrëveshjen e Inkorporuar përfshijnë një sërë formash të këtij bashkëpunimi dhe mjetet me të cilat mund të ndodhë ai, përfshirë ndihmën e ofruar nga organizata shumëpalëshe dhe rajonale.

Neni 3

Inkorporimi i Marrëveshjes BE–Shqipëri

1. Dispozitat e Marrëveshjes BE–Shqipëri në fuqi, menjëherë para se ato të pushojnë së zbatuari për Mbretërinë e Bashkuar, përfshihen në këtë Marrëveshje dhe bëhen pjesë e kësaj Marrëveshjeje, *Mutatis mutandis*, duke iu nënshtuar dispozitave të këtij instrumenti.

2. Detyrimet në deklaratat e përbashkëta të bëra nga palët në Marrëveshjen BE–Shqipëri në lidhje me këtë Marrëveshje dhe të përcaktuara në shtojcën I të këtij instrumenti do të zbatohen me të njëjtin efekt juridik, *Mutatis mutandis*, për Palët në këtë Marrëveshje, duke iu nënshtuar dispozitave të këtij instrumenti.

Neni 4

Referenca ndaj së drejtës së Bashkimit Evropian

1. Përveç kur parashikohet ndryshe, referencat në këtë Marrëveshje lidhur me të drejtën e Bashkimit Evropian duhet të lexohen si referenca për të drejtën e Bashkimit Evropian në fuqi, siç është përfshirë ose zbatuar në ligjin e Mbretërisë së Bashkuar, si e drejtë e mbajtur e Bashkimit Evropian në ditën pasi Mbretëria e Bashkuar pushon së qeni e detyruar të zbatojë të drejtën përkatëse të Bashkimit Evropian.

2. Në këtë nen “e drejta e Mbretërisë së Bashkuar” përfshin të drejtën e territoreve për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është përgjegjëse Mbretëria e Bashkuar ndaj të cilëve

shtrihet kjo Marrëveshje, siç përcaktohet në nenin 6.

Neni 5

Referenca ndaj euros

Pavarësisht nga neni 3(1), referencat ndaj euros (përfshirë “EUR” dhe “€”) në Marrëveshjen e Inkorporuar do të vazhdojnë të lexohen si të tilla në këtë Marrëveshje.

Neni 6

Zbatimi territorial

1. Për shmangien e dyshimit në lidhje me nenin 132 të inkorporuar, kjo Marrëveshje zbatohet në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar, në masën dhe në kushtet e aplikuara në Marrëveshjen BE–Shqipëri menjëherë përpara se ajo të pushojë së zbatuari për Mbretërinë e Bashkuar, në Mbretërinë e Bashkuar dhe territoret e mëposhtme për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave është përgjegjëse Mbretëria e Bashkuar:

a) Gjibraltarin; dhe

b) Ishujt e Kanalit dhe Ishullin e Njeriut (*Channel Islands* dhe *Isle of Man*).

2. Pa cenuar paragrafin 1 dhe nenin 12 të këtij instrumenti, kjo Marrëveshje zbatohet për Gjibraltarin, Ishujt e Kanalit dhe Ishullin e Njeriut nga data e njoftimit me shkrim për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në këto territore nga Mbretëria e Bashkuar për Shqipërinë.

Neni 7

Vijimi i periudhave kohore

1. Në përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë instrument:

a) nëse një periudhë kohore në Marrëveshjen BE–Shqipëri nuk ka përfunduar ende, pjesa tjetër e asaj periudhe do të përfshihet në këtë Marrëveshje; dhe

b) nëse një periudhë kohore në Marrëveshjen BE–Shqipëri ka përfunduar, midis Palëve do të zbatohet çdo e drejtë ose çdo detyrim në vazhdim dhe kjo periudhë nuk do të përfshihet në këtë Marrëveshje.

2. Pavarësisht paragrafit 1, nuk cenohet asnjë referencë ndaj një periudhe në Marrëveshjen e Inkorporuar në lidhje me një procedurë ose çështje



tjetër administrative (të tilla si rishikimet, procedurat e komitetit ose njoftimit).

Neni 8 Kuotat tarifore

1. Në nenin 27(2), shtojcën II(c), shtojcën III, shtojcën II(d) të protokollit 2 dhe shtojcën I të protokollit 3 të Marrëveshjes së Inkorporuar, kuota tarifore ose rritje e saj:

a) riformatohet në 13.62% të vëllimit përkatës të kuotës ose rritjes së kuotës së përmendur në Marrëveshjen BE–Shqipëri, kur ajo pushon së zbatuari mbi Mbretërinë e Bashkuar, e rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt, duke përdorur parimet¹ e zakonshme aritmetike; dhe

b) zbatohet nga Palët që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje mbi baza vjetore.

2. Përveç nëse parashikohet ndryshe në Marrëveshjen e Inkorporuar, periudha e administrimit për një kuotë tarifore, të përmendur në paragrafin 1, do të jetë nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të çdo viti gjatë të cilit është në fuqi kjo Marrëveshje. Nëse kjo Marrëveshje hyn në fuqi pjesërisht përmes një periudhe administrimi, vëllimi i secilës kuotë tarifore do të ndryshohet në madhësi dhe do të zbatohet në bazë *pro-rata* nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje deri më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Neni 9 Dispozitë e mëtejshme në lidhje me Këshillin dhe Komitetin e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit

1. Këshilli, të cilin Palët e themelojnë në bazë të nenit 116 të inkorporuar, siguron veçanërisht që kjo Marrëveshje të funksionojë siç duhet. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, ky Këshill do të njihet me emrin Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit dhe të gjitha referencat ndaj Këshillit të Stabilizim-Asocimit në Marrëveshjen e Inkorporuar (përfshirë çdo komitet të krijuar sipas

¹ Për shmangien e dyshimit, rrumbullakimi duke përdorur parimet e zakonshme aritmetike do të thotë që të gjitha shifrat, të cilat kanë më pak se 50 pas pikës dhjetore do të rrumbullakosen në zbritje në numrin e plotë më të afërt dhe të gjitha shifrat, të cilat kanë më shumë se 50 (përfshirë shifrën 50) pas pikës dhjetore do të rrumbullakosen në ngjitje në numrin e plotë më të afërt.

neneve të inkorporuara 120 deri në 122) do të kuptohen në lidhje me të.

2. Përveç nëse palët bien dakord ndryshe, çdo vendim i miratuar nga Këshilli i Stabilizim-Asocimit ose Komiteti i Stabilizim-Asocimit, i krijuar përmes Marrëveshjes BE–Shqipëri përpara se ajo të pushojë së zbatuari mbi Mbretërinë e Bashkuar, në masën që ato vendime lidhen me Palët e kësaj Marrëveshjeje, konsiderohet se është miratuar, *mutatis mutandis*, dhe u nënshtrohet dispozitave të këtij instrumenti, nga Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit ose Komiteti i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit i Palëve të themeluara sipas neneve përkatëse të inkorporuara 116 dhe 120.

3. Asgjë në paragrafin 2 nuk e ndalon Këshillin e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit ose Komitetin e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit, të krijuar nga kjo Marrëveshje, të marrë vendime të ndryshme për të ndryshuar, modifikuar, revokuar ose shfuqizuar vendimet që konsiderohen se janë miratuar prej tij në bazë të paragrafit 2.

Neni 10 Pjesët përbërëse të kësaj Marrëveshjeje

1. Shtojcat dhe shënimet në fund të faqes së këtij instrumenti janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

2. Asgjë në këtë instrument nuk e cenon nenin 129 të Marrëveshjes së inkorporuar, siç ndryshohet nga ky instrument.

Neni 11 Ndryshimet

1. Palët mund të bien dakord me shkrim që ta ndryshojnë këtë Marrëveshje. Ndryshimi hyn në fuqi ditën e parë të muajit të parë pas datës së njoftimit të Palës së fundit se ajo i ka kryer procedurat e brendshme ose në një datë tjetër që bihet dakord nga Palët.

2. Pavarësisht paragrafit 1, Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit mund të vendosë që shtojcat dhe protokollet e kësaj Marrëveshjeje të ndryshohen. Palët mund të miratojnë vendimin e Këshillit të Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit, në varësi të kërkesave dhe procedurave të tyre ligjore në fuqi.



Neni 12

Hyrja në fuqi dhe zbatimi provizor

1. Nenet 135 dhe 136 të Marrëveshjes BE–Shqipëri nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

2. Secila nga Palët e njofton me shkrim palën tjetër, përmes kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të kërkuara nga e drejta e saj për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi për palën e fundit:

a) datën kur Marrëveshja BE–Shqipëri pushon së zbatuari për Mbretërinë e Bashkuar; dhe

b) datën e njoftimit më të fundit të Palës që ajo ka kryer procedurat e saj të brendshme.

4. Në pritje të hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, shtetet negociuese mund të bien dakord ta zbatojnë përkohësisht këtë Marrëveshje ose dispozita specifike të saj, me një shkëmbim njoftimesh që nënkupton përfundimin e ratifikimit ose procedurat e tjera të brendshme, siç kërkohen për zbatim të përkohshëm. Një aplikim i tillë i përkohshëm hyn në fuqi:

a) në datën kur Marrëveshja BE–Shqipëri pushon së zbatuari për Mbretërinë e Bashkuar; dhe

b) në datën e njoftimeve të shteteve negociuese.

5. Një shtet negociues mund të përfundojë zbatimin e përkohshëm të kësaj Marrëveshjeje, duke njoftuar me shkrim shtetin tjetër negociues. Përfundimi i tillë hyn në fuqi një muaj pas datës së njoftimit.

6. Kur kjo Marrëveshje ose në tërësi, ose dispozita të caktuara të saj, zbatohen përkohësisht, termi “hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje” në çdo dispozitë të zbatuar përkohësisht do të konsiderohet se i referohet datës kur hyn në fuqi zbatimi i tillë i përkohshëm.

7. Mbretëria e Bashkuar i dërgon njoftime sipas këtij neni Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë ose pasardhësit të saj. Shqipëria i dërgon njoftime në bazë të këtij neni Ministrisë së Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar ose pasardhësit të tij.

Në prani të përfaqësuesve, të autorizuar rregullisht nga autoritetet përkatëse, Marrëveshja nënshkruhet nga të dyja Palët.

Bërë në dy kopje në Tiranë, më 5 shkurt 2021, në gjuhët shqipe dhe angleze, ku të dyja tekstet kanë të njëjtën epërsi.

Për Republikën e Shqipërisë:

Olta Xhaçka

Ministër

Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut:

Duncan Norman

Ambasador

SHTOJCË I

Përfshirja e dispozitave të Marrëveshjes BE–Shqipëri në këtë Marrëveshje modifikohet më tej sipas specifikimeve të mëposhtme dhe siç parashikohet në shtojcat II dhe III të kësaj Marrëveshjeje:

1. NDRYSHIMET NË NENIN 1

a) Në pikën e katërt të nenit 1(2), fjalët “gjithashtu përmes përafrimit të legjislacionit të saj me legjislacionin e Komunitetit” nuk përfshihen në Marrëveshje.

**2. NDRYSHIMET NË TITULLIN I
PARIME TË PËRGJITHSHME**

a) Në nenin 3, fjalët “Procesi i Stabilizim-Asocimit, i përmendur në përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian, më 21 qershor 1999. Nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje vijnë në kuadër të përfundimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 29 prill 1997 dhe bazohen në meritat individuale të Shqipërisë” zëvendësohet me “këtë Marrëveshje”.

b) Në nenin 6, paragrafi i tretë dhe i fundit nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

**3. NDRYSHIMET NË TITULLIN II
DIALOGU POLITIK**

a) Në pikën e katërt të nenit 8(2), fjalët “përfshirë bashkëpunimin në fushat e mbuluara



nga Politika e Jashtme e Përbashkët dhe e Sigurisë e Bashkimit Evropian”, nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

b) Në nenin 9(1), përpara “brenda Këshillit të Stabilizim-Asocimit” futen fjalët “midis Palëve, duke përfshirë”.

c) Në nenin 10, fjala “do të” zëvendësohet me “mund” dhe para fjalës “krijohen” vendosen fjalët “që mund të”.

4. NDRYSHIMET NË TITULLIN III BASHKËPUNIMI RAJONAL

a) Në nenin 12:

i. fjalët “Programet e asistencës të Komunitetit mund të mbështesin projekte që kanë përmasa rajonale ose ndërkufitare përmes programeve të asistencës teknike” zëvendësohen me “Mbretëria e Bashkuar mund të ndihmojë ose mbështesë një bashkëpunim të tillë rajonal, përfshirë siç përcaktohet në nenin 13 deri në nenin 15 të Marrëveshjes BE–Shqipëri”; dhe

ii. paragrafi i dytë dhe paragrafi i tretë nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

b) Neni 13 deri në nenin 15 nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

5. NDRYSHIMET NË TITULLIN IV LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

a) Neni 17(2) zëvendësohet me: “Palët angazhohen për bashkëpunim të vazhdueshëm për sigurinë bërthamore, sigurimin dhe mbrojtjen nga rrezatimi, në përputhje me parimet dhe standardet e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (“IAEA”) dhe traktateve dhe konventave ndërkombëtare përkatëse të nënshkruara në kuadrin e IAEA-së.”

b) Pas paragrafit të dytë të nenit 27(1), teksti në vijim futet si paragraf i ri:

“Shtojca IIA përcakton angazhime shtesë në lidhje me produktet e përfshira në kapitujt 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave dhe produkteve të verës.”

c) Në nenin 29, fjalët “jo më vonë se gjashtë vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje” do të zëvendësohen me “brenda një afati kohor të rënë dakord nga Komiteti i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit”.

d) Në nenin 36(3), fjalia e fundit nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

e) Në nenin 43(2), pas “këtij titulli” shtohen fjalët “ose në shtojcën IIA të kësaj Marrëveshjeje”.

f) Neni 45 nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

6. NDRYSHIMET NË TITULLIN V LËVIZJA E PUNONJËSVE, VENDOSJA, FURNIZIMI I SHËRBIMEVE, KAPITALIT

a) Neni 47(1) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

b) Në nenin 48:

i. në pikën e parë të paragrafit (1), fjalët “shtete të ndryshme anëtare” zëvendësohen me “Mbretërinë e Bashkuar dhe shtetet e ndryshme anëtare të Bashkimit Evropian”; dhe

ii. para paragrafit (2), sa vijon, futen si paragrafë të rinj:

“1A. Pavarësisht nga paragrafi 1, pika e parë e paragrafit 1 nuk zbatohet, përveç nëse dhe deri kur Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit:

a) përcakton që janë bërë organizimet e përshtatshme për shpërndarjen e të dhënave për t’i mundësuar Mbretërisë së Bashkuar zbatimin e pikës së parë të paragrafit 1; dhe

b) pasi e ka bërë këtë, vendos të zbatojë dispozitën, me ose pa ndryshime, ose ta zëvendësojë atë.

1B. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit shqyrton çdo zhvillim lidhur me organizimet për ndarjen e të dhënave midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian dhe shqyrton nëse ato janë të përshtatshme për të mundësuar zbatimin e pikës së parë të paragrafit 1”.

c) Në nenin 50(4), fjalët “Pesë vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

d) Në fjalinë e fundit të nenit 50(5)(b), fjalët “Shtatë vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

Në nenin 52(1), fjalët “Marrëveshje shumëpalëshe për krijimin e një zone të përbashkët evropiane të aviacionit (ECAA)” zëvendësohet me “çdo marrëveshje midis Palëve për shërbimet ajrore ose aviacionin”.

e) Në nenin 57(3), fjalia e fundit nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.



f) Në nenin 58(1), fjalët “ditën para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje” zëvendësohen me “31 mars 2009”.

g) Në nenin 58(2), fjalët “data e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje”, në të dyja rastet, zëvendësohet me “1 prill 2009”.

h) Në nenin 59(1):

i. para fjalëve “zbatimi efektiv” shtohet “dhe”; dhe

ii. fjalët “dhe harmonizimi progresiv i legjislacionit shqiptar të transportit me atë të Komunitetit” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

i) Në nenin 59(2), fjalët “dhe evropiane” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

j) Neni 59(6) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

k) Neni 62 nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

l) Pas nenit 69, shtohet si nen i ri neni i mëposhtëm.

“Neni 69A

1. Pavarësisht se kjo Marrëveshje nuk e angazhon Shqipërinë të përafrojë legjislacionin e saj me atë të Mbretërisë së Bashkuar, Palët pranojnë se ekziston një përafrim i legjislacionit të tyre si rezultat i Marrëveshjes BE–Shqipëri në sektorët përkatës. Palët bien dakord që funksionimi i dispozitave të mëposhtme të kësaj Marrëveshjeje varet nga rregullimi i vazhdueshëm i legjislacionit të tyre në sektorët përkatës:

Titulli V (lëvizja e punëtorëve, vendosja, ofrimi i shërbimeve, pagesa aktuale dhe lëvizja e kapitalit):

- kreu I: Lëvizja e punëtorëve (neni 46);

- kreu II: Vendosja (nenet 50, 51(1) dhe 55); dhe

- kreu III: Ofrimi i shërbimeve (nenet 57, 58(1) dhe 59).

2. Nëse një Palë mendon se niveli i nevojshëm i harmonizimit të legjislacionit të tyre nuk është arritur, ajo mund të kërkojë konsultime për këtë çështje. Nëse Palët nuk bien dakord ndryshe, konsultimet sipas këtij neni do të bëhen jo më vonë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për konsultime nga Pala tjetër (“data e kërkesës për konsultim”).

3. Nëse çështja nuk zgjidhet brenda 45 ditëve nga data e kërkesës për konsultim, njëra Palë mund të pezullojë funksionimin e dispozitave të përmendura në paragrafin 1 pasi të ketë njoftuar Palën tjetër në përputhje me paragrafin 4.

4. Pezullimi në paragrafin 3 nuk do të bëhet më shpejt se 90 ditë nga data e dorëzimit të njoftimit të përmendur në këtë paragraf.

5. Në rast se njëra Palë pezullon dispozitat sipas paragrafit 3, Palët u ofrojnë shërbimeve ose furnitorëve të Palës tjetër trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që u jepet shërbimeve ose furnitorëve të ngjashëm të çdo vendi të tretë. Trajtimi preferencial i dhënë nga secila Palë për shërbimet ose furnitorët e shërbimeve të një vendi të tretë në përputhje me GATS, përjashtohet nga ky paragraf”.

7. NDRYSHIMET NË TITULLIN VI PËRAFRIMI I LIGJEVE, ZBATIMI I LIGJEVE DHE RREGULLAT E KONKURENCËS

a) Neni 70 nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

b) Neni 71(2) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

c) Në nenin 71(4), fjalët “në përputhje me paragrafin 2” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

d) Në nenin 71(5), fjalët “pas metodologjisë dhe prezantimit të sondazhit të Komunitetit” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

e) Në nenin 71(6), fjalët “dhe përafrojnë skema të tilla të ndihmës me kriteret e përmendura në paragrafin 2 brenda një periudhe jo më shumë se katër vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

f) Në nenin 71(7), paragrafi i dytë nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

g) Në nenin 71(8), pika e dytë nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

h) Neni 72 zëvendësohet me:

“Në lidhje me sipërmarrjet publike dhe sipërmarrjet të cilave u janë dhënë të drejta të veçanta ose ekskluzive, Palët sigurojnë që nuk ka miratuar dhe as mbajtur ndonjë masë që shtrembëron tregtinë midis Palëve në kundërshtim me interesat e Palëve. Ky nen nuk duhet të pengojë realizimin në ligj ose në fakt të detyrave të veçanta të caktuara për këto sipërmarrje”.

i) Neni 73(2) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

j) Në nenin 74(2), paragrafi i dytë zëvendësohet si më poshtë:



“Mbretëria e Bashkuar shqyrton në mënyrë periodike mundësinë e zbatimit të dispozitave të mësipërme për kontratat në sektorin e shërbimeve.”

k) Në nenin 74(5), fjalët “46 deri në 69” zëvendësohen me “46 deri në 61 dhe 63 deri në 69”.

l) Neni 75(1) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

m) Në nenin 75(2), fjalët “për këtë qëllim,” dhe pika e parë dhe e katërt nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

n) Në nenin 76:

i. në paragrafin e parë, fjalia e parë nuk përfshihet në këtë Marrëveshje;

ii. në pikën e parë të paragrafit të dytë, fjalët “në përputhje me të drejtën e Komunitetit” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje; dhe

iii. pika e dytë e paragrafit të dytë zëvendësohet me “krijimin e legjislacionit të përshtatshëm për mbrojtjen e konsumatorit”.

o) Neni 77 nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

8. NDRYSHIMET NË TITULLIN VII DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA

a) Në nenin 79, fjalia e parë zëvendësohet si më poshtë:

“në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria duhet të ketë legjislacion në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe duhet të marrë parasysh parimet dhe udhëzimet e organeve përkatëse ndërkombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale.”

b) Neni 81(3) zëvendësohet si më poshtë:

“Palët përcaktojnë procedurat për ripranimin, duke përfshirë ripranimin e shtetasve të vendeve të tjera dhe të personave pa shtetësi.”

c) Neni 81(4) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

d) Në nenin 82(2), fjalët “Komuniteti dhe” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

e) Në nenin 83(2), fjalët “në përputhje me Strategjinë e BE-së për Kontrollin e Drogave” nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

9. NDRYSHIMET NË TITULLIN VIII POLITIKAT E BASHKËPUNIMIT

a) Në nenin 87(2), fjalët “dhe gradualisht për të përafshuar politikat e veta me politikat e orientuara drejt stabilitetit të Unionit Ekonomik dhe Monetar” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

b) Neni 87(4) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

c) Në nenin 88, fjalët e mëposhtme nuk përfshihen në Marrëveshje:

i. “të lidhura me *acquis*-in e Komunitetit”;

dhe

ii. “Kodi Evropian i Praktikës Statistike dhe parashikimet e së drejtës statistikore evropiane dhe zhvillimi drejt *acquis*-it të Komunitetit”.

d) Në nenin 89, fjalët “që lidhen me *acquis*-in e Komunitetit” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

e) Në nenin 90, fjalët “që lidhen me *acquis*-in e Komunitetit” dhe “dhe praktikat më të mira të BE-së” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

f) Neni 92 (3) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

g) Në nenin 93, fjalët “në lidhje me *acquis*-in e Komunitetit” dhe “si dhe parimet e mishëruara në Kartën Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

h) Në nenin 94(1), fjalia e fundit nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

i) Në nenin 95, fjalët e mëposhtme nuk përfshihen në këtë Marrëveshje:

i. “në lidhje me *acquis*-in e Komunitetit”; dhe

ii. “dhe në përkrahjen e përafrimit gradual të legjislacionit dhe praktikave shqiptare me rregullat dhe standardet e Komunitetit”.

j) Në nenin 96, fjalët “në lidhje me *acquis*-in e Komunitetit” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

k) Në nenin 97(1), fjalët e mëposhtme nuk përfshihen në këtë Marrëveshje:

i. “dhe për arritjen e përafrimit të sistemit doganor të Shqipërisë me sistemin doganor të Komunitetit”; dhe

ii. “dhe për përafrimin gradual të legjislacionit doganor shqiptar me *acquis*-in”.

l) Neni 97(2) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

m) Në nenin 98(2), fjalët “që lidhen me *acquis*-in e Komunitetit” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.



n) Neni 99(2) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

o) Neni 100(3) dhe 100(4) nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

p) Neni 102(3) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

q) Neni 103(1) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

r) Neni 104(1) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

s) Në nenin 104(2), fjalët “në veçanti” dhe “me objektivin përfundimtar të miratimit nga ana e Shqipërisë të *acquis*-it të Komunitetit në këta sektorë një vit pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

t) Neni 106(1) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

u) Në nenin 106(2), fjalët “duke arritur standarde operimi të krahasueshme me ato të Komunitetit, duke zhvilluar një sistem transporti në Shqipëri të pajtueshëm dhe të përafëruar me sistemin e Komunitetit” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

v) Në nenin 107, fjalët “në lidhje me *acquis*-in e Komunitetit” dhe “bazuar në Traktatin e nënshkruar të Komunitetit të Energjisë” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

w) Neni 108(2) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

x) Neni 109(2) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

y) Neni 110(2) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

10. NDRYSHIMET NË TITULLIN IX BASHKËPUNIMI FINANCIAR

a) Në nenin 112:

i. fjalët “neni 3, 113 dhe 115” zëvendësohen nga “neni 3”.

ii. fjalët që fillojnë nga “nga Komuniteti në formën e granteve dhe kredive” deri në fund të këtij neni do të zëvendësohen me “nga Mbretëria e Bashkuar, në varësi të marrëveshjes midis të dyja palëve. Mbretëria e Bashkuar gjithashtu mund të bashkëpunojë me nismat e përcaktuara në nenet 112 deri në 115 të Marrëveshjes BE–Shqipëri, në varësi të marrëveshjes midis të gjitha palëve.”

b) Neni 113 deri në nenin 115 nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

11. NDRYSHIMET NË TITULLIN X DISPOZITA INSTITUCIONALE, TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

a) Në nenin 117(1), në secilin rast, pas fjalëve “anëtarëve”, shtohen fjalët “ose përfaqësuesit”.

b) Neni 117(5) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

c) Në nenin 121:

i. para fjalës “krijimit” shtohen fjalët “aty ku është e përshtatshme”; dhe

ii. fjalët “dhe monitorimi i Planit të Veprimit të BE-së për Shqipërinë dhe rajonin fqinj” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

d) Në paragrafin e parë të nenit 122:

i. fjalët “në këtë dokument” zëvendësohen me “mund të”; dhe

ii. pas fjalës “krijohen” shtohen fjalët “nga Palët”.

e) Neni 128 nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

f) Në nenin 129, paragrafi i dytë nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

g) Neni 131 nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

h) Në nenin 132, fjalët “Traktatet që themelojnë Komunitetin Evropian dhe Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike” zëvendësohen me “Traktatin për Bashkimin Evropian dhe Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian”.

i) Neni 133 nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

j) Neni 134, duke përfshirë shënimin (1) në fund të faqes, nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

k) Neni 137 nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

12. NDRYSHIMET NË SHTOJCËN V TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE, INDUSTRIALE DHE TREGTARE

a) Në paragrafin 1, fjalët “ose të cilat aplikohen *de facto* nga shtetet anëtare” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

b) Paragrafi 3 nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.



13. MODIFIKIMET NË PROTOKOLLIN 1 PRODUKTET E HEKURIT DHE ÇELIKUT

- a) Neni 5(2) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.
- b) Në nenin 5(4), fjalët “paragrafët 2 dhe 3” zëvendësohen me “paragrafi 3”.
- c) Në nenin 5(5), fjalët “deri në pikën 4” zëvendësohen me “3 dhe 4”.

14. NDRYSHIMET NË PROTOKOLLIN 3 MBI KONCESIONET PREFERENCIALE RECIPROKE PËR DISA LLOJE VERE, NJOHJA RECIPROKE DHE KONTROLLI I VERËRAVE, PIJEVE ALKOOLIKE DHE EMRAT E VERËRAVE TË AROMATIZUARA

a) Në fund të nenit 2(a)(ii) të shtojcës II, shtohet formulimi i mëposhtëm si shënim në fund të faqes:
“Emërtimet *Irish Whiskey*, *Uisce Beatha Eireannach*, *Irish Whiskey* dhe *Irish Cream*, të listuara në shtojcën I, pjesa A, mbulojnë pijet alkooolike të prodhuara në Republikën e Irlandës dhe Irlandën e Veriut.”

b) Neni 11(2), shtojca II, zëvendësohet me:
“Shqipëria cakton Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si organin e saj përfaqësues. Mbretëria e Bashkuar cakton Departamentin për Mjedisin, Ushqimin dhe Çështjet Rurale si organin e saj përfaqësues. Secila Palë Kontraktuese njofton Palën tjetër Kontraktuese nëse ndryshon organin e saj përfaqësues”.

c) Në shtojcën II, shtojca I, pjesët A(a) dhe (c), përcaktimet gjeografike që lidhen me pjesë të Bashkimit Evropian që nuk janë Mbretëria e Bashkuar nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

d) Në shtojcën II, shtojca I, pjesa A(b) zëvendësohet me:

“b) PIJET ALKOOLIKE ME ORIGINË NË MBRETËRINË E BASHKUAR

1. a) Whiskey

Scotch whiskey

Irish whisky

(Këto përcaktime mund të plotësohen me termat “*malt*” ose “*drithë*”)

b) Whiskey

Irish whiskey

Uisce Beatha Eireannach/Irish whiskey

(Këto përcaktime mund të plotësohen me termat “*pot still*”)

2. Liqueur

Krem irlandez

e) Në shtojcën II, shtojca 2, shprehjet tradicionale që lidhen me pjesë të Bashkimit Evropian që nuk janë Mbretëria e Bashkuar nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

f) Në shtojcën II, shtojca 3, paragrafët (a) dhe (b) zëvendësohen me:

“Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetër për pikat e tyre përkatëse të kontaktit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.”

15. NDRYSHIMET NË PROTOKOLLIN 5 TRANSPORTI TOKËSOR

a) Neni 13(2) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

b) Neni 13(3) zëvendësohet nga:

c) Neni 4 deri në nenin 6 nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

d) Neni 8 deri në nenin 10 nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

e) Në nenin 11(1), paragrafi i dytë nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

f) Në nenin 11(3), fjalët:

i. “Në akset rrugore të përmendura në nenin 5” zëvendësohet me “në Shqipëri”; dhe

ii. “Dhe problemet që lindin në të njëjtat rrethana në territorin e Komunitetit afër kufijve shqiptarë”, nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

g) Në pikën e parë të nenit 12, fjalët “nga njëra anë, me përfundimin e Tregut të Brendshëm të Komunitetit dhe zbatimin e politikës së përbashkët të transportit dhe, nga ana tjetër, me politikën ekonomike dhe të transportit të Shqipërisë” zëvendësohen me “me politikën ekonomike dhe të transportit të tyre”.

h) Neni 13(2) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

i) Neni 13(3) zëvendësohet me:

“Palët do të kërkojnë të eliminojnë diskriminimin midis transportuesve të Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë kur vendosin taksa dhe tarifa për qarkullimin dhe/ose posedimin e automjeteve të rënda, si dhe taksa ose tarifa të vendosura për operacionet e transportit në territorin e Palëve.”

j) Në nenin 13(4), fjalët “Deri në përfundimin e Marrëveshjes së përmendur në paragrafin 2 dhe në nenin 12” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.



k) Në nenin 14(1):

i. fjalët “në rrugët e mbuluara nga neni 5” zëvendësohen me “në Shqipëri dhe Mbretërinë e Bashkuar”; dhe

ii. fjalja e dytë nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

l) Neni 14(2) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

m) Neni 16(1) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

n) Neni 16(4) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

o) Në nenin 17(1), fjalët “dhe përpqen të harmonizojnë legjislacionin e tyre” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

p) Neni 17(3) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

q) Në nenin 17(4), fjalët “harmonizohen” zëvendësohen me mbledhin përvojën e tyre në lidhje me”.

r) Neni 18(1) nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

s) Neni 19 nuk përfshihet në këtë Marrëveshje.

t) Neni 21(2)(c) dhe (d) nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

16. NDRYSHIMET NË PROTOKOLLIN 6 NDIHMJA E NDËRSJELLË ADMINISTRATIVE NË ÇËSHTJET DOGANORE

a) Në nenin 10 (2), fjalët “duke përfshirë, sipas nevojës, dispozita ligjore në fuqi në shtetet anëtare të Komunitetit” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

b) Në nenin 13(1), fjalët “shërbimet kompetente të Komisionit të Komuniteteve Evropiane” nuk përfshihen në këtë Marrëveshje.

c) Në nenin 14(1), formulimet në vijim nuk përfshihen në këtë Marrëveshje:

i. fjalët “duke marrë në konsideratë kompetencat përkatëse të Komunitetit dhe shteteve anëtare”; dhe

ii. pika e tretë.

d) Neni 14(2) zëvendësohet me: “Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 1, dispozitat e këtij protokollin do të kenë përparësi ndaj dispozitave të çdo Marrëveshjeje dypalëshe për ndihmën e ndërsjellë të lidhur midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Shqipërisë përpara datës së nënshkrimit të

kësaj Marrëveshjeje për sa kohë dispozitat e kësaj të fundit janë të papajtueshme me ato të këtij protokollin”.

17. DEKLARATAT E PËRBASHKËTA

Neni 3(2) i këtij instrumenti u referohet deklaratave të përbashkëta të mëposhtme:

a) deklaratës së përbashkët të lidhur me nenin 61 të kësaj Marrëveshjeje;

b) deklaratës së përbashkët të lidhur me nenin 73 të kësaj Marrëveshjeje;

c) deklaratës së përbashkët të lidhur me nenin 126 të kësaj Marrëveshjeje; dhe

d) deklaratës së përbashkët të lidhur me protokollin 5 të kësaj Marrëveshjeje.

SHTOJCË II

Pas shtojcës II të Marrëveshjes së inkorporuar shtohet shtojca e re e mëposhtme:

SHTOJCË IIA MARRËVESHJE SHITESË PREFERENCIALE PËR PRODUKTE CAKTUARA BUJQËSORE DHE VERËRA

Kjo shtojcë parashikon marrëveshje shtesë preferenciale të përkohshme dhënë nga Mbretëria e Bashkuar për Shqipërinë për disa produkte bujqësore dhe verëra.

Neni 1

Marrëveshje preferenciale për produkte caktuara bujqësore me origjinë në Shqipëri

Pavarësisht nga neni 27(1) i Marrëveshjes së Inkorporuar, për kohën kur është në fuqi kjo shtojcë, produktet me origjinë në Shqipëri të përfshira në kapitujt 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinar pranoen për import në Mbretërinë e Bashkuar, duke u përjashtuar nga detyrimet doganore dhe tarifatat specifike që kanë efekt të barasvlershëm.



Neni 2

Marrëveshje preferenciale për verëra të caktuara me origjinë në Shqipëri

1. Për verën, siç listohet në titullin e kësaj shtojce, me origjinë nga Shqipëria, tarifat doganore të zbatueshme për importet në Mbretërinë e Bashkuar, nën paragrafin 2, pezullohen në nivele brenda kufijve të kuotave tarifore të Mbretërisë së Bashkuar dhe brenda kushteve të përcaktuara për verën në shtojcën e këtij titulli.

2. Aksesit të verës me origjinë nga Shqipëria në kuotën tarifore të parashikuar në shtojcën e këtij titulli i nënshtrohet shterimit paraprak të kuotave tarifore të parashikuara në shtojcën I të protokollit 3 (të modifikuar nga neni 8 i këtij instrumenti).

3. Neni 8(2) i këtij instrumenti zbatohet për këtë shtojcë.

Neni 3

Kohëzgjatja e marrëveshjeve preferenciale

1. Marrëveshjet preferenciale të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të kësaj shtojce skadojnë pesë vjet pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Pas skadimit të kësaj shtojce, marrëveshjet preferenciale për ato produkte të përmendura në nenet 1 dhe 2 do të parashikohen diku tjetër në këtë Marrëveshje.

3. Pavarësisht paragrafit 1, Mbretëria e Bashkuar mund, me dorëzimin e njoftimit paraprak me shkrim gjashtë muaj përpara për Shqipërinë, ose në një periudhë tjetër njoftimi të dakordësuar nga Palët, të zgjasë kohëzgjatjen e kësaj shtojce për një periudhë që gjykohet e përshtatshme.

Neni 4

Marrëdhënia me Marrëveshjen e Inkorporuar

Neni 119 i Marrëveshjes së inkorporuar nuk zbatohet mbi këtë shtojcë.

Shtojcë**Tabela e Marrëveshjeve Preferenciale për Verën**

Nr. i urdhërit	Kodi ² CN	Përshkrimi	Volumi i kuotës për vit	Niveli i përjashtimit tatimor
09.1532	ex 2204 21 93 ex 2204 21 94 ex 2204 21 95 ex 2204 21 96 ex 2204 21 97 ex 2204 21 98 ex 2204 22 93 ex 2204 22 94 ex 2204 22 95 ex 2204 22 96 ex 2204 22 97 ex 2204 22 98 ex 2204 29 93 ex 2204 29 94 ex 2204 29 95 ex 2204 29 96 ex 2204 29 97 ex 2204 29 98	Verë me rrush të freskët, me një fuqi aktuale alkoolike në vëllim që nuk e tejkalon 15% të vëllimit, përveç verës së gazuar.	681 hl	Përjashtim

²Pavarësisht rregullave për interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar, formulimi për përshkrimin e produkteve konsiderohet të jetë vetëm tregues, dhe skema preferenciale përcaktohet, brenda kontekstit të kësaj Shtojce, nga mbulimi i kodeve CN. Kur tregohen kodet ex CN, skema preferenciale përcaktohet nga aplikimi i kombinuar i kodit CN dhe përshkrimi përkatës.



SHTOJCË III

Protokolli 4 i Marrëveshjes BE-Shqipëri zëvendësohet nga:

TITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

Për qëllimet e këtij protokoll:

a) “prodhim” do të thotë çdo lloj punimi ose procesi, duke përfshirë bashkimin, montimin, ose operacionet specifike;

b) “material” do të thotë çdo lloj përbërësi, lëndë e parë, përbërës ose pjesë etj., të përdorura për prodhimin e produktit;

c) “produkt” do të thotë produkti që është prodhuar edhe nëse është për t’u përdorur më vonë në një proces tjetër prodhimi;

d) “mallra” përfshin së bashku materialet dhe produktet;

e) “vlera doganore” do të thotë vlera e përcaktuar në përputhje me Marrëveshjen e vitit 1994 mbi zbatimin e nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifën dhe Tregtinë GATT;

f) “çmimi *ex-works*” do të thotë çmimi i paguar për produktin e prodhuar (*ex-works*) të prodhuesit në Mbretërinë e Bashkuar, ose në Shqipëri, për të cilin kryhet punimi ose përpunimi i fundit, me kusht që çmimi të përfshijë vlerën e të gjitha materialeve të përdorura minus taksat e brendshme, të cilat janë ose mund të jenë të rimbursueshme kur produkti i përfituar eksportohet;

g) “vlera e materialeve” do të thotë vlera doganore në kohën e importimit të materialeve joorigjinuese të përdorura, ose, nëse kjo nuk është e njohur dhe nuk mund të përcaktohet, çmimi i parë i përcaktuar i paguar për materialet në Shqipëri ose në Mbretërinë e Madhe;

h) “vlera e materialeve origjinuese” do të thotë vlera e materialeve të tilla siç përcaktohet në paragrafin (g) të zbatuara *mutatis mutandis*;

i) “vlera e shtuar” do të thotë çmimi *ex-works* minus vlerën doganore të secilit nga materialet e përfshira, të cilat e kanë origjinën nga vendet e tjera të përmendura në nenet 3 dhe 4 me të cilat zbatohet kumulimi, ose, kur vlera doganore nuk

është e njohur, ose nuk mund të jetë e vërtetuar, çmimi i parë i vërtetuar i paguar për materialet në Shqipëri ose në Mbretërinë e Bashkuar.

j) “kapitujt” dhe “krerët” nënkuptojnë kapitujt dhe krerët (kodet katërshifrore) të përdorura në nomenklaturë, të cilat përbëjnë përshkrimin e harmonizuar të mallrave dhe sistemin e kodeve, referuar në këtë protokoll si “Sistemi i harmonizuar” ose “HS”;

k) “i klasifikuar” i referohet klasifikimit të një produkti ose materiali nën një kre të veçantë;

l) “dërgesa” do të thotë produkte që dërgohen njëkohësisht nga një eksportues të një marrësi i dërgesës ose të shoqëruara me një dokument të vetëm transporti që mbulon transportimin e tyre nga eksportuesi të marrësi, ose në mungesë të një dokumenti të tillë, nga një faturë e vetme;

m) “territoret” përfshijnë ujërat territoriale;

n) “Shtojca I deri në shtojcën IVb të inkorporuara” nënkuptojnë shtojcat I deri në IVb të shtojcës I të Konventës Rajonale mbi Rregullat Pan-Euro-Mesdhetare Preferenciale të Origjinës, pasi ato shtojca inkorporohen në nenin 40 të këtij protokoll.

TITULLI II
PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT
“PRODUKTE ORIGJINUESE”

Neni 2
Kërkesa të përgjithshme

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, produktet e mëposhtme do të konsiderohen si origjinuese në Mbretërinë e Bashkuar:

a) produktet tërësisht të përfituara në Mbretërinë e Bashkuar brenda kuptimit të nenit 5 të këtij protokoll;

b) produktet e përfituara në Mbretërinë e Bashkuar, që përfshijnë materiale që nuk janë përfituar tërësisht atje, me kusht që materiale të tilla të kenë kaluar në përpunim ose procese të mjaftueshme në Mbretërinë e Bashkuar brenda kuptimit të nenit 6 të protokollit.

2. Për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, produktet e mëposhtme do të konsiderohen si origjinuese në Shqipëri:

a) produktet tërësisht të përfituara në Shqipëri në përputhje me kuptimin e nenit 5 të këtij protokoll,



b) produktet e përfituara në Shqipëri që përfshijnë materiale që nuk kanë qenë tërësisht të përfituara atje, me kusht që materiale të tilla të kenë kaluar në përpunime apo procese të mjaftueshme në Shqipëri, në përputhje me nenin 6 të këtij protokoll.

Neni 3

Kumulimi në Mbretërinë e Madhe

1. Pa cenuar dispozitat e nenit 2(1), produktet konsiderohen me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar, nëse ato janë përfitur atje, duke përfshirë materiale me origjinë nga Zvicra (përfshirë Lihtenshtejin)³, Islandën, Norvegjinë, Turqinë ose Bashkimin Evropian, me kusht që punimi ose përpunimi i kryer në Mbretërinë e Bashkuar të shkojë përtej veprimeve të përmendura në nenin 7. Nuk është e nevojshme që materiale të tilla të kenë kaluar një punim ose përpunim të mjaftueshëm.

2. Pa cenuar dispozitat e nenit 2(1), produktet konsiderohen me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar nëse ato janë përfitur atje, duke përfshirë materiale me origjinë nga Shqipëria ose ndonjë vend tjetër i përmendur në shtojcën A të këtij protokoll, me kusht që punimi ose përpunimi i kryer në Mbretërinë e Bashkuar të shkojë përtej veprimeve të përmendura në nenin 7. Nuk është e nevojshme që materialet e tilla të kenë kaluar një përpunim ose përpunim të mjaftueshëm.

3. Pa cenuar dispozitat e nenit 2(1), puna ose përpunimi i kryer në Islandë, Norvegji ose në Bashkimin Evropian, konsiderohet se është kryer në Mbretërinë e Bashkuar kur produktet e marra i nënshtrohen punës ose përpunimit të mëvonshëm në Mbretërinë e Bashkuar në masën që shkon përtej veprimeve të përmendura në nenin 7.

4. Për kumulimin e parashikuar në paragrafët 1 dhe 2, kur punimi ose përpunimi i kryer në Mbretërinë e Bashkuar nuk shkon përtej veprimeve të përmendura në nenin 7, produkti i përfitur konsiderohet me origjinë në Mbretërinë e Bashkuar vetëm kur vlera e shtuar është më e madhe se vlera e materialeve të përdorura që e kanë origjinën në ndonjë prej vendeve të tjera. Nëse nuk është

kështu, produkti i përfitur do të konsiderohet me origjinë nga vendi që ka vlerën më të lartë të materialeve origjinale të përdorura në prodhim në Mbretërinë e Bashkuar.

5. Për kumulimin e parashikuar në paragrafin 3, kur punimi ose përpunimi i kryer në Mbretërinë e Bashkuar nuk tejkalon veprimet e përmendura në nenin 7, produkti i përfitur konsiderohet si me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar vetëm kur vlera e shtuar atje është më e madhe se vlera e shtuar në secilin prej vendeve të tjera.

6. Produktet me origjinë nga vendet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2, të cilat nuk i nënshtrohen asnjë punimi ose përpunimi në Mbretërinë e Bashkuar ruajnë origjinën e tyre nëse eksportohen në një nga këto vende.

7. a) Kumulimi i parashikuar në këtë nen në lidhje me Bashkimin Evropian mund të zbatohet me kusht që:

i. Shqipëria, Mbretëria e Bashkuar dhe Bashkimi Evropian të kenë marrëveshje mbi bashkëpunimin administrativ që sigurojnë zbatimin e saktë të këtij neni;

ii. materialet dhe produktet kanë fituar statusin e origjinës me zbatimin e rregullave identike të origjinës me ato të këtij protokoll; dhe

iii. njoftimet që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme për të aplikuar kumulimin të jenë botuar nga Palët.

b) Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga paragrafi 7(a), kumulimi i parashikuar në këtë nen mund të zbatohet me kusht që:

i. është e zbatueshme një marrëveshje tregtare preferenciale në përputhje me nenin XXIV të GATT 1994 midis vendeve të përfshira në marrjen e statusit të origjinës dhe vendit të destinacionit;

ii. materialet dhe produktet kanë fituar statusin e origjinës me zbatimin e rregullave identike të origjinës me ato të këtij protokoll; dhe

iii. Palët kanë botuar njoftimet që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme për të aplikuar akumulimin.

8. Mbretëria e Bashkuar i ofron Shqipërisë detaje mbi marrëveshjet ose planet, duke përfshirë datat e hyrjes në fuqi të tyre, dhe rregullat përkatëse të origjinës, të cilat zbatohen me vendet e tjera të përmendura në paragrafët 1 dhe 2.

³ Për shkak të Traktatit Doganor midis Zvicrës dhe Lihtenshtejnit, produktet me origjinim në Lihtenshtejn do të konsiderohen si me origjinim në Zvicër.



Neni 4

Kumulimi në Shqipëri

1. Pa cenuar dispozitat e nenit 2(2), produktet do të konsiderohen me origjinë nga Shqipëria, nëse ato janë përfituar aty, duke përfshirë materialet me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar, Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin), Islandën, Norvegjinë, Turqinë ose Bashkimi Evropian, me kusht që punimi ose përpunimi i kryer në Shqipëri të shkojë përtej operacioneve të përmendura në nenin 7. Nuk është e nevojshme që materiale të tilla të kenë kaluar përpunim ose procesim të mjaftueshëm.

2. Pa cenuar dispozitat e nenit 2(2), produktet do të konsiderohen me origjinë nga Shqipëria nëse ato janë përfituar aty, duke përfshirë materiale me origjinë nga çdo vend i referuar në shtojcën A të këtij protokolli, me kusht që punimi ose përpunimi i kryer në Shqipëri shkon përtej operacioneve të përmendura në nenin 7. Për këto materiale nuk është e nevojshme që ato t'i nënshtrohen punimit ose përpunimit të mjaftueshëm.

3. Kur punimi ose përpunimi i kryer në Shqipëri nuk i tejkalon operacionet e përmendura në nenin 7, produkti i përfituar konsiderohet me origjinë nga Shqipëria vetëm kur vlera e shtuar atje është më e madhe se vlera e materialeve të përdorura që janë me origjinë nga cilido prej vendeve të tjera të përmendura në paragrafët 1 dhe 2. Nëse nuk është kështu, produkti i përfituar do të konsiderohet si me origjinë nga vendi që ka vlerën më të lartë të materialeve origjinuese të përdorura për prodhim në Shqipëri.

4. Produktet me origjinë nga vendet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2, të cilat nuk i nënshtrohen asnjë punimi ose përpunimi në Shqipëri, ruajnë origjinën e tyre nëse eksportohen në një nga këto vende.

5. a) Kumulimi i parashikuar në këtë nen në lidhje me Bashkimin Evropian mund të zbatohet me kusht që:

i. Shqipëria, Mbretëria e Bashkuar dhe Bashkimi Evropian kanë marrëveshje mbi bashkëpunimin administrativ, që sigurojnë zbatimin e duhur të këtij neni;

ii. materialet dhe produktet kanë fituar statusin e origjinës me zbatimin e rregullave identike të origjinës me ato të këtij protokolli; dhe

iii. njoftimet që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme për të aplikuar akumulimin janë botuar nga Palët.

b) Me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 5(a), kumulimi parashikuar në këtë nen mund të aplikohet me kusht që:

i. është e zbatueshme një marrëveshje tregtare preferenciale në përputhje me nenin XXIV të GATT 1994 midis vendeve të përfshira në marrjen e statusit të origjinës dhe vendit të destinacionit;

ii. materialet dhe produktet kanë fituar statusin e origjinës me zbatimin e rregullave identike të origjinës me ato të këtij protokolli; dhe

iii. Palët kanë botuar njoftimet që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme për të aplikuar akumulimin.

6. Shqipëria i jep Mbretërisë së Bashkuar detaje ose informacione të tjera, duke përfshirë datat e hyrjes së tyre në fuqi dhe rregullat e tyre të origjinës, të cilat zbatohen në vende të tjera të përmendura në paragrafët 1 dhe 2.

Neni 5

Produktet tërësisht të përftuara

1. Produktet e mëposhtme do të konsiderohen tërësisht të përftuara në Shqipëri ose në Mbretërinë e Bashkuar:

a) produktet minerale të nxjerra nga shtresat e tyre tokësore dhe nëntoka ujore e detit;

b) produktet bimore të kultivuara atje;

c) kafshët e gjalla të lindura dhe të rritura atje;

d) produkte nga kafshët e gjalla të rritura atje;

e) produktet e përftuara nga gjuetia apo peshkimi të kryera atje;

f) produktet e peshkimit në det ose produkte të tjera të marra nga deti jashtë ujërave territoriale të Palës eksportuese nga anijet e saj;

g) produktet të prodhuara ekskluzivisht nga produktet e përmendura në germën (f) në bordin e anijeve-fabrikë të saj;

h) artikujt e përdorur, të mbledhur atje, që përshtaten vetëm për përfitim të lëndëve të para, duke përfshirë gomat e përdorura të përshtatshme vetëm për ritrajtim ose që përdoren si mbetje;

i) mbetjet dhe skrapet që vijnë nga operacionet prodhuese të kryera atje;

j) produktet e nxjerra nga toka ose nëntoka detare, jashtë ujërave të saj territoriale, me kusht që



të ketë të drejta ekskluzive për të punuar në atë tokë ose nëntokë;

k) mallrat e prodhuara atje ekskluzivisht nga produktet e specifikuar në nënparagrafin nga (a) deri në germën (j).

2. Termi “anijet e saj” dhe “anijet e përpunimit” në paragrafin 1(f) dhe (g) aplikohen vetëm për mjetet lundruese dhe anijet e përpunimit:

a) të cilat janë të regjistruara ose mbahen në Shqipëri ose në Mbretërinë e Madhe;

b) të cilat lundrojnë nën flamurin të Shqipërisë ose e Mbretërisë së Madhe;

c) të cilat janë në pronësi të mbi të paktën 50 për qind nga nënshtetas të Shqipërisë, një shteti anëtar të Bashkimit Evropian, ose të Mbretërisë së Bashkuar, ose nga një kompani me seli në një nga këto shtete, menaxheri apo menaxherët e të cilëve, kryetari i Bordit të Drejtorëve ose Bordi Mbikëqyrës dhe shumica e anëtarëve të bordeve të tilla janë nënshtetas, të Shqipërisë të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose të Mbretërisë së Bashkuar dhe përveç kësaj, në rast partneriteti ose të kompanive aksionare të paktën gjysma e kapitalit i përket atij shteti ose organeve publike ose nënshtetasve të shtetit në fjalë;

d) në të cilat kapiteni dhe oficerët janë nënshtetas të Shqipërisë, të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose të Mbretërisë së Bashkuar; dhe

e) në të cilat të paktën 75 për qind e ekuipazhit janë nënshtetas, të Shqipërisë të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose të Mbretërisë së Bashkuar.

Neni 6

Produkte të punuara ose të përpunuara në masë të mjaftueshme

1. Për qëllime të nenit 2, produktet të cilat nuk janë tërësisht të përfutuara konsiderohen të punuara ose të përpunuara mjaftueshëm kur përmbushen kushtet e përcaktuara në listën e shtojcës II.

Kushtet e përmendura në paragrafin më sipër i referohen punimit ose përpunimit nën të cilat do të kalojnë materialet joorigjinuese të përdorura për prodhim dhe do të aplikohen vetëm në lidhje me materiale të tilla. Rezulton se nëse një produkt, i cili ka kërkuar statusin e origjinës duke përmbushur kushtet e përcaktuara në listë, përdoret për prodhimin e një produkti tjetër, kushtet e aplikueshme mbi produktin ku ai është inkorporuar

nuk aplikohen mbi të, dhe nuk do të merren parasysh materialet joorigjinuese, të cilat mund të jenë përdorur për prodhimin e tij.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, materialet joorigjinuese të cilat, sipas kushteve të përcaktuara në listën e shtojcës II të përfshirë, nuk përdoren për prodhimin e një produkti, mund edhe të përdoren, me kusht që:

a) vlera e tyre totale nuk e kalon 10 për qind% të çmimit *ex-works* të produktit;

b) asnjë përqindje e dhënë në listë për vlerën maksimale të materialeve joorigjinuese të mos tejkalohet bazuar në këtë paragraf.

Ky paragraf nuk zbatohet për produktet që rrjedhin nga kapitujt 50 deri në 63 të Sistemit të Harmonizuar.

3. Paragrafët 1 dhe 2 zbatohen bazuar në dispozitat e nenit 7.

Neni 7

Punime ose përpunime të pamjaftueshme

1. Pa cenuar paragrafin 2, veprimet e mëposhtme konsiderohen si punime ose përpunime të pamjaftueshme për t'i dhënë statusin e origjinës produktit, pavarësisht nëse përmbushen ose jo kërkesat e nenit 6:

a) kryerja e proceseve për të siguruar që produkti mbahet në kushte të mira gjatë transportit dhe magazinimit;

b) ndarja dhe bashkimi i paketimeve;

c) larja, pastrimi, heqja e pluhurit, oksideve, vajit, bojës ose shtresave të tjera;

d) hekurosja ose presimi i tekstileve;

e) proceset e thjeshta të lyerjeve apo lustrimit;

f) tharja, zbardhja e pjesshme ose e përgjithshme, shkëlqimi dhe ndriçimi i farërave dhe orizit;

g) procesi i ngjyrosjes së sheqerit ose dhënia e formave të ndryshme sheqerit;

h) qërimi, pastrimi i pjesës së brendshme të frutave, perimeve dhe arrave;

i) ndarjet, bluarjet ose prerjet e thjeshta;

j) heqja e pjesëve mbuluese, mbrojtja nga dëmtuesit e jashtëm, përzgjedhjet, klasifikimi, përshkallëzimet dhe matjet (duke përfshirë krijimin e seteve të artikujve);

k) tendosja e thjeshtë në shishe, kanaçe, epruveta, çanta, valixhe, kuti, fiksimi i tyre në



kartonë apo dërrasa ose mbështjellësve, si dhe të gjitha proceset e tjera të paketimit të thjeshtë;

l) fiksimi ose printimi i markave, etiketave, logove, si dhe i shenjave të tjera të dallueshme mbi produkte ose mbi paketimin e tyre;

m) përzierja e thjeshtë e produkteve, pavarësisht nëse i përkasin llojeve të ndryshme apo jo;

n) përzierja e sheqerit me çfarëdo materiali tjetër;

o) montimi i thjeshtë i pjesëve të artikujve për të ndërtuar një artikull të plotë ose çmontimi i produkteve në pjesë;

p) kombinimi i dy ose më shumë proceseve të specifikuara në nënparagrafët nga (a) në (n); (q) therja e kafshëve.

2. Të gjitha proceset që kryhen në Shqipëri ose në Mbretërinë e Bashkuar mbi një produkt të caktuar do të konsiderohen së bashku, në rastet kur përcaktohet se punimi ose përpunimi mbi të cilat ka kaluar produkti janë të pamjaftueshme brenda kuptimit të paragrafit 1.

Neni 8

Njësia e kualifikimit

1. Njësia e kualifikimit për zbatimin e dispozitave të këtij protokollit quhet produkti i veçantë, i cili konsiderohet si njësi bazë me qëllim klasifikimin sipas nomenklaturës së Sistemit të Harmonizuar.

Përkatësisht, procedohet si më poshtë:

a) kur një produkt i përbërë nga një grup ose bashkim artikujsh klasifikohet nën termat e Sistemit të Harmonizuar në një krye të vetëm, e gjithë njësia përbën njësien e kualifikimit;

b) kur një dërgesë përbëhet nga një numër produktesh identike të klasifikuara nën të njëjtin krye të Sistemit të Harmonizuar, çdo produkt duhet të merret individualisht gjatë zbatimit të dispozitave të këtij protokollit.

2. Kur, nën rregullin e përgjithshëm 5 të Sistemit të Harmonizuar, paketimi përfshihet në produkt për qëllime klasifikimi, ai do të përfshihet për qëllime të përcaktimit të origjinës.

Neni 9

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentet

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentet e lidhura me një pjesë pajisjeje, makinerie, aparati apo mjeti, të cilat janë pjesë e një pajisjeje normale dhe përfshihen në çmim të saj ose nuk janë të ndara dukshëm në faturë, konsiderohen si një me pjesën e pajisjes, makinerisë, aparatit ose mjetit në fjalë.

Neni 10

Kompletet

Kompletet, sipas përkufizimit në rregullin e përgjithshëm 3 të Sistemit të Harmonizuar, konsiderohen si origjinues kur të gjitha produktet përbërëse janë origjinues. Megjithatë, kur një komplet përbëhet nga produkte origjinues dhe joorigjinues, kompleti si i tërë do të konsiderohet si origjinues, me kusht që vlera e produkteve joorigjinues të mos kalojë 15 për qind të çmimit “*ex works*” të kompletit.

Neni 11

Elementet neutrale

Me qëllim përcaktimin nëse një produkt është origjinues ose jo nuk është e nevojshme të përcaktohet origjina e zërave të mëposhtëm, të cilët mund të jenë përdorur gjatë prodhimit të tij:

a) energjia dhe karburanti;

b) fabrika dhe pajisjet;

c) makineritë dhe veglat;

d) mallrat të cilat as nuk hyjnë në përbërjen përfundimtare të produktit dhe as nuk synojnë të hyjnë.

TITULLI III

KËRKESAT TERRITORIALE

Neni 12

Parimi i territorialitetit

1. Në përjashtim të rasteve kur parashikohet në nenet 3, 4 dhe paragrafin 3 të këtij neni, kushtet për përfundimin e statusit origjinues të përcaktuar në titullin II, duhet të përmbushen pa ndërprerje nga Shqipëria ose nga Mbretëria e Bashkuar.



2. Në përjashtim të rasteve kur parashikohet në nenet 3 dhe 4, kur mallrat e eksportuara origjinuese nga Shqipëria ose nga Mbretëria e Madhe në një vend tjetër kthehen, ato konsiderohen si joorigjinuese, në përjashtim të rasteve ku demonstron në mënyrë bindëse për autoritetet doganore që:

a) mallrat e kthyera janë të njëjta me ato që janë eksportuar; dhe

b) ato nuk i janë nënshtruar ndonjë procesi tjetër përveç atyre të nevojshme për t'i ruajtur ato në kushte të mira gjatë kohës që kanë ndenjur në atë vend ose gjatë eksportimit.

3. Përfitimi i statusit origjinues në përputhje me kushtet e përcaktuara në titullin II nuk ndikohen nga punimi apo përpunimi i kryer jashtë Shqipërisë ose Mbretërisë së Bashkuar ndaj materialeve të eksportuara nga Shqipëria ose Mbretëria e Bashkuar dhe riimportuar atje, me kusht që:

a) materialet në fjalë të jenë plotësisht të përfuara në Shqipëri ose Mbretërinë e Bashkuar, ose t'i jenë nënshtruar punimit apo përpunimit përtej veprimeve të listuara në nenin 7 përpara eksportimit; dhe

b) të binden autoritetet doganore, që:

i. mallrat e riimportuara janë përfuqar duke punuar apo përpunuar materialet e eksportuara; dhe

ii. vlera totale e shtuar e përfuqar jashtë Shqipërisë ose Mbretërisë së Madhe sipas zbatimit të dispozitave të këtij neni nuk e kalon 10% të çmimit *ex-works* të produktit përfundimtar për të cilin kërkohet statusi origjinues.

4. Për qëllime të paragrafit 3, kushtet për përfitimin e statusit origjinues përcaktuar në titullin II nuk zbatohen për punimin ose përpunimin e bërë jashtë Shqipërisë ose Mbretërisë së Bashkuar. Në rastet kur, në listën e shtojcës II të inkuorporuar, zbatohet rregulli i përcaktuar që ka të bëjë me vlerën maksimale të të gjitha materialeve të bashkëngjitura joorigjinuese, në përcaktimin e statusit të origjinës së produktit përfundimtar, vlera totale e materialeve të bashkëngjitura joorigjinuese në territorin e Palës përkatëse së interesuar, marrë së bashku me vlerën totale të shtuar të përfuqar jashtë Shqipërisë ose Mbretërisë së Bashkuar përmes zbatimit të dispozitave të këtij neni, nuk duhet të tejkalojë përqindjen e përcaktuar.

5. Për qëllime të zbatimit të dispozitave të paragrafëve 3 dhe 4, “vlera totale e shtuar” do të

merret në kuptimin e të gjitha kostove të bëra jashtë Shqipërisë ose Mbretërisë së Bashkuar, përfshi dhe vlerën e materialeve të trupëzuara në të.

6. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 nuk zbatohen ndaj produkteve që nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në listën e shtojcës II dhe të cilat mund të konsiderohen të punuara ose përpunuara në masë të mjaftueshme vetëm nëse zbatohen vlerat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 6(2).

7. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 nuk zbatohen për produktet e kapitujve nga 50 deri në 63 të Sistemit të Harmonizuar.

8. Për çdo lloj pune apo përpunimi që është objekt i dispozitave të këtij neni dhe është kryer jashtë Shqipërisë ose Mbretërisë së Bashkuar, duhet proceduar me rregulla të përpunimit pasiv ose rregullave të ngjashme.

Neni 13

Transporti i drejtpërdrejtë

1. Trajtimi preferencial i parashikuar në Marrëveshje aplikohet vetëm për produktet që i përmbushin kërkesat e këtij protokollit, të cilat janë transportuar drejtpërsëdrejti midis Palëve. Sidoqoftë, produktet që përbëhen nga një dërgesë e vetme mund të transportohen nëpërmjet territoreve të tjera përmes, nëse paraqitet e nevojshme, lëvizjeve transit ose magazinimit të përkohshëm në këto territore, me kusht që ato të qëndrojnë nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore të vendit transit ose të magazinimit dhe nuk kryejnë operacione të tjera veç atyre të ngarkim-shkarkimit, ose ndonjë operacion tjetër me synim për t'i mbajtur ato në kushte të mira.

2. Produktet origjinuese mund të transportohen me nënkalime përmes territorit të ndryshëm nga territori i palëve.

3. Të dhënat që vërtetojnë përmbushjen e plotë të kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 i jepen autoriteteve doganore të vendit importues, të cilat duhet të përfshijnë:

a) një dokument të vetëm transporti që tregon kalimin nga vendi eksportues përmes vendit transit; ose

b) një certifikatë të lëshuar nga autoritetet doganore të vendit transit:

i. ku jepet një përshkrim i saktë i produkteve;



ii. ku jepen datat e shkarkimit dhe ngarkimit të produkteve dhe, nëse është e zbatueshme, emrat e anijeve, ose llojet e tjera të transportit të përdorur; si dhe

iii. një vërtetim i kushteve në të cilat ka qëndruar produkti në vendin transit;

c) nëse nuk mundësohen këto dokumente, çdo dokument tjetër thelbësor.

Neni 14

Ekspozitat

1. Produktet origjinuese të dërguara për ekspozim në një vend tjetër të ndryshëm nga vendet e përmendura në nenet 3 dhe 4, me të cilat aplikohet kumulimi, dhe të shitura pas ekspozimit për import në Mbretërinë e Bashkuar dhe Shqipëri, përfitojnë në import, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, me kusht që autoritetet doganore të binden se:

a) eksportuesi i ka dërguar këto produkte nga Shqipëria ose Mbretëria e Bashkuar në vendin ku bëhet ekspozita dhe i ka ekspozuar ato atje;

b) produktet janë shitur ose, në të kundërt, i janë vënë në dispozicion nga ky eksportues personit në Shqipëri ose në Mbretërinë e Bashkuar;

c) produktet janë dorëzuar gjatë ekspozitës ose menjëherë pas saj në shtetin ku ato janë dërguar për ekspozim; dhe

d) produktet nuk janë përdorur, që nga momenti kur ato janë dërguar në ekspozitë, për asnjë qëllim tjetër veçse atij të ekspozimit.

2. Vërtetimi i origjinës lëshohet ose bëhet në përputhje me dispozitat e titullit V dhe depozitohet pranë autoriteteve doganore të Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar në formë normale. Emri dhe adresa e ekspozitës duhet të jenë të shprehura qartë në të. Kur paraqitet e nevojshme, mund të kërkojnë të dhëna shtesë dokumentare në lidhje me kushtet e ekspozimit të produkteve.

3. Paragrafi 1 aplikohet për çdo lloj ekspozimi, panairi ose shfaqje ose prezantim të ngjashëm publik tregtar, industrial, bujqësor ose punime me dorë, të cilët nuk organizohen për qëllime private në dyqane apo mjedise biznesi me synimin e shitjes së mallrave nga jashtë, dhe gjatë të cilëve produktet i nënshtrohen kontrollit doganor.

TTULLI IV

RIMBURSIMI OSE PËRJASHTIMI

Neni 15

Ndalimi i rimbursimit prej tarifave doganore ose përjashtimeve nga tarifat doganore

1. Materialet joorigjinuese të përdorura për prodhimin e një produkti origjinues në Shqipëri ose në Mbretërinë e Bashkuar, për të cilat vërtetimi i origjinës lëshohet ose bëhet në përputhje me dispozitat e titullit V, nuk janë as në Mbretërinë e Bashkuar, as në Shqipëri, objekt rimbursimi, ose përjashtimi nga detyrimet doganore të çdo lloji.

2. Ndalimi i parashikuar në paragrafin 1 zbatohet për çdo lloj rregullimi për rimbursim, lehtësim apo mospagim, të pjesshëm ose të plotë të detyrimeve doganore apo detyrimeve të tjera me të njëjtin efekt, të zbatueshme në Shqipëri ose në Mbretërinë e Bashkuar, për materialet e përdorura për prodhim, ku rimbursimet, lehtësimet apo mospagimi i tillë zbatohet shprehimisht ose në fuqi, kur produktet e përfutuara nga materialet e mësipërme eksportohen dhe jo kur ato mbahen për përdorim atje.

3. Eksportuesi i produkteve të mbuluara me provë origjine duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë me kërkesën e autoriteteve doganore, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë se nuk është bërë asnjë rimbursim në lidhje me materialet joorigjinuese të përdorura për prodhimin e produkteve në fjalë dhe se të gjitha detyrimet doganore ose detyrimet e tjera me të njëjtin efekt të zbatueshëm në të tilla materiale aktualisht janë paguar.

4. Dispozitat e paragrafëve nga 1 deri në 3, zbatohen gjithashtu për paketimin brenda kuptimit të nenit 8(2), aksesoret, pjesët e këmbimit dhe instrumentet, brenda kuptimit të nenit 9 dhe produkteve në komplete, brenda kuptimit të nenit 10, kur artikuj të tillë janë joorigjinues.

5. Dispozitat e paragrafëve nga 1 deri në 4 zbatohen vetëm për materialet të cilat janë të llojit për të cilat aplikohet Marrëveshja.



TITULLI V PROVA E ORIGJINËS

Neni 16

Kërkesa të përgjithshme

1. Produktet origjinuese në njërin nga Palët, gjatë importimit në Palën tjetër, përfitojnë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje pas paraqitjes së njëres prej vërtetimeve të mëposhtme të origjinës:

a) një certifikatë e lëvizjes së mallrave EUR.1, një formë e së cilës tregohet në shtojcën IIIa të inkorporuar;

b) një certifikatë e lëvizjes së mallrave EUR-MED, një formë e së cilës tregohet në shtojcën IIIb të inkorporuar; ose

c) në rastet e specifikuara në nenin 22(1), një deklaratë (më poshtë e njohur si “deklarata e origjinës”, ose “deklarata e origjinës EUR-MED”) dhënë nga eksportuesi në një faturë, një notë dërguese ose dokument tjetër tregtar ku përshkruhen produktet përkatëse në detaje të mjaftueshme për t'u identifikuar. Tekstet e deklaratave të origjinës jepen në shtojcat IVa dhe b të inkorporuara.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, produktet origjinuese në kuptimin e këtij protokolli, për sa u takon rasteve të specifikuara në nenin 27, përfitojnë nga kjo Marrëveshje, pa qenë e nevojshme të depozitojnë ndonjë nga vërtetimet e origjinës të përmendura në paragrafin 1 më sipër.

3. Pavarësisht nga paragrafi 5 i nenit 17 dhe paragrafi 3 i nenit 22 më poshtë, ku kumulimi përfshin vetëm Mbretërinë e Bashkuar, Bashkimin Evropian, Zvicrën (përfshirë Lihtenshtejnin), Islandën, Norvegjinë, Ishujt Faroe, Turqinë, Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Malin e Zi, Republikën e Serbisë ose Republikën e Kosovës, prova e origjinës mund të jetë një certifikatë lëvizëse mallrash EUR.1 ose një deklaratë origjine.

Neni 17

Procedura për lëshimin e certifikatës lëvizëse të mallrave EUR.1 ose EUR-MED

1. Certifikata e lëvizjes së mallrave EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të vendit eksportues mbështetur në aplikimin e bërë me

shkrim nga eksportuesi ose, nën përgjegjësinë e eksportuesit, nga përfaqësuesi i tij i autorizuar.

2. Për këtë qëllim, eksportuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar plotësojnë të dyja dokumentet, certifikatën lëvizëse të mallrave EUR.1 ose EUR-MED dhe formularin e aplikimit, ekzemplar të të cilave jepen në shtojcën IIIa dhe b të inkorporuara. Këta formularë do të plotësohen në një nga gjuhët e përdorura prej të cilave kjo marrëveshje është hartuar dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit të brendshëm të vendit eksportues. Nëse formularët janë plotësuar me shkrim dore, ata do të plotësohen me bojë me germa kapitale. Përshkrimi i produkteve duhet të jepet në një kuti të rezervuar për këtë qëllim pa lënë ndonjë rresht bosh. Kur kutia nuk është e plotësuar tërësisht, hiqet një vijë horizontale poshtë vijës së fundit të përshkrimit, duke e përshkruar të gjithë hapësirën bosh.

3. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e certifikatës lëvizëse të mallrave EUR.1 ose EUR-MED përgatitet për të depozituar në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të vendit eksportues ku është lëshuar certifikata e lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin e origjinës së produktit në fjalë, si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij protokolli.

4. Pa cenuar paragrafin 5, certifikata lëvizëse e mallrave EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të Mbretërisë së Bashkuar ose Shqipërisë në rastet e mëposhtme:

a) nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen me origjinë në Shqipëri ose në Mbretërinë e Bashkuar, pa zbatuar kumulimin me materialet që e kanë origjinën në Zvicër (duke përfshirë Lihtenshtejnin), Turqinë, një ndër vendet e përmendura në nenin 3(2) dhe nenin 4(2) dhe plotësojnë kërkesat e tjera të këtij protokolli.

b) nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga një prej vendeve të tjera të përmendura në nenin 3 dhe nenin 4, me të cilat është i aplikueshëm kumulimi, pa zbatuar kumulimin për materialet me origjinë nga një prej vendeve të përmendura në nenin 3 dhe nenin 4, dhe plotësojnë kërkesat e tjera të këtij protokolli, me kusht që certifikata EUR-MED ose deklarata e origjinës EUR-MED të jenë lëshuar në vendin e origjinës.



5. Certifikata e lëvizjes së mallrave EUR-MED lëshohet nga autoritetet doganore të Mbretërisë së Bashkuar ose të Shqipërisë, nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga Mbretëria e Bashkuar, nga Shqipëria ose nga një nga vendet e përmendura në nenin 3 dhe nenin 4 me të cilët zbatohet kumulimi, kur përmbushen kërkesat e këtij protokolli, dhe:

a) kumulimi zbatohet me materiale origjinuese nga Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin), Turqia ose një nga vendet e përmendura në nenin 3(2) dhe nenin 4(2); ose

b) produktet mund të përdoren si materiale në kontekstin e kumulimit për prodhimin e produkteve për eksport në një nga vendet e përmendura në nenin 3 dhe nenin 4; ose

c) produktet mund të riekportohen nga vendi i destinacionit në një nga vendet e përmendura në nenin 3 dhe nenin 4.

6. Certifikata lëvizëse e mallrave EUR-MED përmban një prej deklaratave të mëposhtme në gjuhën angleze në rubrikën 7:

a) nëse origjina është përfituar me anë të aplikimit të kumulimit me materiale origjinuese nga një ose më shumë vende të përmendura në nenin 3 dhe nenin 4:

“CUMULATION APPLIED WITH... (*emri i vendit/vendëve*)”

b) nëse origjina është përfituar pa aplikimin e kumulimit me materiale origjinuese nga një ose më shumë nga vendet e përmendura në nenin 3 dhe nenin 4:

“NO CUMULATION APPLIED”

7. Autoritetet doganore që lëshojnë certifikatën lëvizëse të mallrave EUR-MED ndërmarrin masa apo hapa të nevojshëm për të verifikuar statusin origjinues të produkteve dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij protokolli. Për këtë qëllim, ato kanë të drejtë të kërkojnë çdo provë apo të ndërmarrin çdo inspektim të llogarive financiare të eksportuesit ose çdo kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të nevojshëm. Autoritetet doganore gjithashtu sigurojnë që formularët e përmendur në paragrafin 2 plotësohen siç duhet. Në veçanti, ata kontrollojnë nëse hapësira e rezervuar për përshkrimin e produkteve është plotësuar në mënyrë të tillë që përjashton të gjitha mundësitë e shtesave false.

8. Data e lëshimit të certifikatës së lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED tregohet në kutinë 11 të certifikatës.

9. Certifikata e lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED lëshohet nga autoritetet doganore dhe i vihet në dispozicion eksportuesit sapo të jetë kryer ose siguruar eksportimi aktual.

Neni 18

Certifikatat e lëvizjes EUR.1 ose EUR-MED të lëshuara aposteriori

1. Pavarësisht nga neni 17(7), certifikatat e lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED mund përjashtimisht të lëshohet pas eksportimit të produkteve të cilave iu referohet, nëse:

a) ajo nuk është lëshuar në kohën e eksportimit për shkak të gabimeve ose mungesave të pavullnetshme ose rrethanave të veçanta; ose

b) është demonstruar në mënyrë të kënaqshme pranë autoriteteve doganore që certifikata e lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED është lëshuar, por nuk është pranuar gjatë importimit për arsye teknike.

2. Pavarësisht nga neni 17(9), certifikata e lëvizjes EUR-MED mund të lëshohet pas eksportimit të produkteve me të cilat lidhet ajo dhe për të cilën është lëshuar një certifikatë lëvizëse EUR.1 në kohën e eksportimit, me kusht që të demonstrohet në mënyrë të kënaqshme për autoritetet doganore që janë përmbushur kushtet e përmendura në nenin 17(5).

3. Për zbatimin e paragrafit 1, eksportuesi duhet të tregojë në aplikimin e tij vendin dhe datën e eksportimit të produkteve për të cilat lëshohet certifikata e lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED dhe të tregojë arsyet për këtë kërkesë.

4. Autoritetet doganore mund të lëshojnë një certifikatë të lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED aposteriori vetëm pasi të jetë verifikuar se informacioni i dhënë nga eksportuesi në aplikim është i njëjtë me atë të dosjeve korresponduese.

5. Certifikata e lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED e lëshuar aposteriori në zbatim të nenit 1 mbyllet me një nga frazat e mëposhtme në gjuhën angleze:

“ISSUED RETROSPECTIVELY”

6. Certifikata e lëvizjes së mallrave EUR-MED e lëshuar aposteriori mbi bazën e paragrafit 2 mbyllet me një nga frazat e mëposhtme në gjuhën angleze:



“ISSUED RETROSPECTIVELY (Original EUR.1 No... [data dhe vendi i lëshimit]”

6. Frazat e përmendura në paragrafin 5 do të vendosen në kutinë 7 të certifikatës së lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED.

Neni 19

Lëshimi i dublikatit të certifikatës së lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED

1. Në rast vjedhjeje, humbjeje apo shkatërrimi të një certifikate të lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED eksportuesi mund të aplikojë tek autoritetet doganore të cilat e kanë lëshuar atë, për një dublikatë, e cila bëhet në bazë të dokumenteve të eksportit në zotërim të tyre.

2. Dublikata e lëshuar në këtë mënyrë duhet të mbyllet me një nga fjalët e mëposhtme në anglisht; “DUPLICATE”

3. Shënimi i referuar në paragrafin 2 vendoset në kutinë 7 të dublikatës së certifikatës të lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED.

4. Dublikata e cila duhet të tregojë dhe datën e lëshimit të certifikatës origjinale të lëvizjes së mallrave EUR ose EUR-MED, hyn në fuqi që nga ajo datë.

Neni 20

Lëshimi i certifikatave të lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED në bazë të lëshimit të një prove origjine të lëshuar ose të bërë më herët

Kur produktet origjinuese vendosen nën kontrollin e një zyre doganore në Shqipëri ose Mbretërinë e Bashkuar, është i mundur zëvendësimi i provës origjinale të origjinës me një ose më shumë certifikata të lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED për qëllime të dërgimit të të gjitha produkteve, ose të disa prej tyre diku brenda Shqipërisë ose Mbretërisë së Bashkuar. Zëvendësimi i certifikatës ose certifikatave të lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED lëshohet nga zyra doganore nën kontrollin e së cilës gjenden këto produkte.

Neni 21

Ndarja e llogarive kontabël

1. Kur paraqiten kosto ose vështirësi materiale të konsiderueshme në mbajtjen e rezervave (stokut) të ndara të materialeve origjinuese dhe joorigjinuese të cilat janë identike dhe të këmbyeshme, autoritetet doganore mund, me kërkesë me shkrim të personave të interesuar, të autorizojnë të ashtuquajturën metodën e “ndarjes së llogarive kontabël” (më poshtë “metoda”), që do të përdoret për administrimin e rezervave të tilla.

2. Metoda siguron që, për një periudhë specifike reference, numri i produkteve të marra që mund të konsiderohen si “origjinuese” të jetë i njëjtë me numrin të që do të ishte marrë nëse do të kishte ndarje fizike të rezervave.

3. Autoritetet doganore mund të bëjnë dhënien e autorizimit, të përmendur në paragrafin 1, pas përmbushjes së kushteve që konsiderohen të përshtatshme.

4. Metoda zbatohet dhe aplikimi i saj regjistrohet në bazë të parimeve të përgjithshme të kontabilitetit të zbatueshme në vendin ku prodhohet produkti.

5. Përfituesi i metodës mund të paraqesë ose të aplikojë për prova të origjinës, sipas rastit, për sasinë e produkteve që mund të konsiderohen si origjinuese. Me kërkesë të autoriteteve doganore, përfituesi siguron deklaratën lidhur me menaxhimin e sasive.

6. Autoritetet doganore monitorojnë përdorimin e autorizimit dhe mund ta tërheqin atë sa herë që përfituesi e përdor autorizimin në mënyrë jo të duhur në çfarëdo mënyre, ose nëse nuk arrin të përmbushë ndonjë prej kushteve të tjera të përcaktuara në këtë protokoll.

Neni 22

Kushtet për lëshimin e deklaratës së origjinës EUR-MED

1. Deklarata e origjinës ose deklarata e origjinës EUR-MED, siç përmendet në nenin 16(1)(c) mund të përgatitet:

a) nga një eksportues i miratuar në kuptimin e nenit 23; ose

b) nga një eksportues i ndonjë dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që



përmbajnë produkte origjinuese, vlera totale e të cilave nuk i kalon 6 000 euro.

2. Pa cenuar paragrafin 3, deklarata e origjinës mund të bëhet në rastet në vijim:

a) nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga Shqipëria ose nga Mbretëria e Bashkuar, pa zbatimin e kumulimit për materiale me origjinë nga Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin), Turqinë ose një nga vendet e tjera të përmendura në nenin 3(2) dhe nenin 4(2) dhe nëse produktet në fjalë i përmbushin kërkesat e tjera të këtij protokolli; ose

b) nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte origjinuese në një nga vendet të tjera të përmendura në nenin 3 dhe nenin 4, me të cilat është i aplikueshëm kumulimi, pa aplikimin e kumulimit me materiale me origjinë nga një prej vendeve të përmendura në nenin 3 dhe nenin 4, dhe që përmbushin kërkesat e tjera të këtij protokolli, me kusht që të jetë lëshuar një certifikatë EUR-MED ose një deklaratë origjinë EUR-MED në vendin e origjinës.

3. Deklarata e origjinës EUR-MED mund të lëshohet nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen si produkte me origjinë nga Shqipëria, Mbretëria e Bashkuar ose në një nga vendet e tjera të përmendura në nenin 3 dhe nenin 4 me të cilat kumulimi është i zbatueshëm, dhe kur përmbushen kërkesat e këtij protokolli, në rastet e mëposhtme:

a) kumulimi është aplikuar me materiale me origjinë nga Zvicra (përfshirë Lihtenshtejnin), Turqinë ose një nga vendet e tjera të përmendura në nenin 3(2) dhe nenin 4(2); ose

b) produktet mund të përdoren si materiale në kuadrin e kumulimit për prodhimin e produkteve për eksport në një nga vendet e tjera të përmendura në nenin 3 dhe nenin 4; ose

c) produktet mund të rieksporthen nga vendi i destinacionit në një nga vendet e tjera të përmendura në nenin 3 dhe nenin 4.

4. Deklarata e origjinës EUR-MED përmban një nga fjalitë e mëposhtme në anglisht:

1. nëse origjina është marrë nga zbatimi i kumulimit me materiale me origjinë nga një ose më shumë nga vendet e përmendura në nenin 3 dhe nenin 4:

“CUMULATION APPLIED WITH... (emri i vendit/vendeve)”

2. nëse origjina është marrë pa zbatimin e kumulimit me materiale me origjinë nga një ose më shumë nga vendet e përmendura në nenin 3 dhe nenin 4:

“NO CUMULATION APPLIED”

5. Eksportuesi që bën një deklaratë të origjinës ose një deklaratë të origjinës EUR-MED përgatitet të paraqesë në çdo kohë, me kërkesë të autoriteteve doganore të Palës eksportuese, të gjitha dokumentet e duhura që dëshmojnë statusin e origjinës së produkteve në fjalë, si dhe përmbushjen e kërkesave të tjera të këtij protokolli.

6. Deklarata e origjinës ose deklarata e origjinës EUR-MED bëhet nga eksportuesi duke shtypur, vulosur ose printuar në faturë, notën dërgese ose një dokument tjetër tregtar, deklaratën, tekstet e së cilave gjenden në shtojcat e inkorporuara IVa dhe b, duke përdorur një nga versionet e gjuhëve të paraqitura në ato shtojca dhe në përpunje me dispozitat e ligjit kombëtar të vendit eksportues. Nëse deklarata është shkruar me shkrim dore, ajo duhet të shkruhet me bojë me shkronja kapitale.

7. Deklaratat e origjinës dhe deklaratat e origjinës EUR-MED mbajnë nënshkrimin origjinal të eksportuesit në të shkruar me dorë. Sidoqoftë, eksportuesi i miratuar në kuptimin e nenit 23 nuk kërkohet të nënshkruajë deklarata të tilla me kusht që ai t'u japë autoriteteve doganore të Palës eksportuese një dokument me shkrim ku ai pranon përgjegjësinë e plotë për çdo deklaratë të origjinës që e identifikon atë sikur të kishte qenë nënshkruar me dorë prej tij.

8. Deklarata e origjinës ose deklarata e origjinës EUR-MED mund të bëhet nga eksportuesi kur produktet të cilave ajo i referohet janë eksportuar, ose pas eksportit, me kushtin që të paraqitet në vendin importues, jo më vonë se dy vjet pas importimit të produkteve të cilave ajo i referohet.

Neni 23

Eksportuesi i miratuar

1. Autoritetet doganore të vendit eksportues mund të autorizojnë çdo eksportues (më poshtë “eksportuesi i miratuar”), i cili realizon dërgesa të shpeshta të mallrave sipas kësaj Marrëveshjeje, të lëshojë deklaratat e origjinës, ose deklaratat e origjinës EUR-MED pavarësisht nga vlera e produkteve në fjalë. Eksportuesi që kërkon një autorizim të tillë, duhet të paraqesë, sipas kërkesave



të autoriteteve doganore, të gjitha garancitë e nevojshme për të vërtetuar statusin e origjinës së produkteve, si dhe të përmbushë kërkesat e tjera të këtij protokollit.

2. Autoritetet doganore mund të japin statusin e eksportuesit të miratuar, kur ata e gjykojnë të përshtatshme.

3. Autoritetet doganore i japin eksportuesit të miratuar një numër autorizimi doganor, i cili shfaqet në deklaratën e origjinës, ose në deklaratën e origjinës EUR-MED.

4. Autoritetet doganore monitorojnë përdorimin e autorizimeve nga eksportuesi i miratuar.

5. Autoritetet doganore mund të tërheqin autorizimin në çdo kohë. Autoritetet doganore mund ta bëjnë këtë kur eksportuesi i miratuar nuk ofron garancitë e parashikuara në paragrafin 1, si dhe nuk përmbush kërkesat e përmendura në paragrafin 2, ose kur e përdor autorizimin në mënyrë jokorrekte.

Neni 24

Vlefshmëria e provës së origjinës

1. Prova e origjinës është e vlefshme për katër muaj nga data e lëshimit në vendin eksportues, dhe duhet depozituar brenda kësaj periudhe tek autoritetet doganore të vendit importues.

2. Provat e origjinës të cilat janë depozituar pranë autoriteteve doganore të vendit importues pas datës së fundit të dorëzimit, e specifikuar në paragrafin 1, mund të pranohen me qëllim zbatimin e trajtimit preferencial, kur nuk është arritur depozitimi i këtyre dokumenteve deri në datën përfundimtare, shkaktuar nga rrethana përjashtimore.

3. Në rastet e tjera të dorëzimeve të vonuara, autoritetet doganore të vendit importues mund ta pranojnë provën e origjinës kur produktet janë depozituar përpara datës përkatëse përfundimtare.

Neni 25

Paraqitja e provës së origjinës

Prova e origjinës dorëzohet pranë autoriteteve doganore të vendit importues në përputhje të plotë me procedurat që aplikohen në atë vend. Autoritetet e mësipërme mund të kërkojnë përkthimin e provës së origjinës dhe gjithashtu

mund të kërkojnë deklaratën e importit, të shoqëruar nga deklarata e importuesit që vërteton se produktet i përmbushin kushtet e kërkuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 26

Importimi me këste

Kur, me kërkesën e importuesit dhe në varësi të kushteve të parashtruara nga autoritetet doganore të vendit importues, produktet e ndara ose jo të grupuara në kuptimin e rregullit të përgjithshëm 2(a) të Sistemit të Harmonizuar, që bien nën seksionet XVI dhe XVII apo në kërçet nr. 7308 dhe 9406, janë importuar me dërgesë të parë, pranë autoriteteve doganore dorëzohet prova e origjinës për të tilla produkte gjatë importimit të dërgesës së parë.

Neni 27

Përjashtimet nga prova e origjinës

1. Produktet e dërguara në paketime të vogla nga persona privatë për persona privatë ose që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtareve pranohen si produkte origjinuese pa kërkuar paraqitjen e provës së origjinës, nëse sigurohet se këto produkte nuk janë importuar për qëllime tregtie dhe janë deklaruar se i përmbushin kërkesat e këtij protokollit dhe kur nuk ka dyshim të vërtetësia e një deklarimi të tillë. Në rastin e produkteve të dërguara me postë, kjo deklaratë mund të bëhet në deklarinimin doganor CN22/CN23, ose në një fletë të veçantë letre që i bashkëlidhet këtij dokumenti.

2. Importet të cilat janë të rastësishme dhe përbëjnë vetëm produkte për përdorim personal nga marrësi, ose udhëtari, ose familjarët e tyre, nuk konsiderohen si importe për qëllime tregtie nëse nisur nga pikëpamja e natyrës dhe sasisë së produkteve është e dukshme që nuk ka qëllime tregtie lidhur me to.

3. Për më tepër, vlera totale e këtyre produkteve nuk duhet të tejkalojnë 500 euro në rastin e pakove të vogla, ose 1 200 euro në rastin e produkteve që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtareve.



Neni 28

Dokumentet mbështetëse

Dokumentet e përmendura në nenet 17(3) dhe 22(5) të përdorura me qëllim të provimit se produktet e mbuluara nga një certifikatë lëvizjeje EUR.1 ose EUR-MED, ose një deklaratë origjine ose deklaratë origjine EUR-MED mund të konsiderohen si produktet me origjinë nga Shqipëria, nga Mbretëria e Bashkuar ose nga një nga vendet e tjera të përmendura në nenet 3 dhe 4 dhe përmbushin kërkesat e tjera të këtij protokoll, mund të përbëjnë, *inter alia*, nga sa vijon:

a) provë të drejtpërdrejtë të proceseve të kryera nga eksportuesi ose ofruesi për të marrë mallrat në fjalë, të përfshira, për shembull, në llogaritë e tij ose regjistrimin e brendshëm;

b) dokumente që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në Mbretërinë e Bashkuar ose në Shqipëri ku këto dokumente përdoren në përputhje me ligjin kombëtar;

c) dokumente që vërtetojnë punën ose përpunimin e materialeve në Mbretërinë e Bashkuar ose në Shqipëri, të lëshuara ose të bëra në Mbretërinë e Bashkuar ose në Shqipëri, ku këto dokumente përdoren në përputhje me ligjin kombëtar;

d) certifikatat e lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED, ose deklaratat e origjinës ose deklaratat e origjinës EUR-MED, të cilat vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në Mbretërinë e Bashkuar ose në Shqipëri, në përputhje me këtë protokoll, ose në një prej vendet e tjera të përmendura në nenin 3 dhe nenin 4, në përputhje me rregullat e origjinës të cilat janë identike me rregullat në këtë protokoll;

e) të dhëna të përshtatshme në lidhje me punën ose përpunimin e bërë jashtë Mbretërisë së Bashkuar, Shqipërisë ose vendeve të tjera të përmendura në nenin 3 dhe nenin 4 me zbatimin e nenit 12, të cilat dëshmojnë përmbushjen e kërkesave të këtij neni.

Neni 29

Ruajtja e provës së origjinës dhe e dokumenteve mbështetëse

1. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një certifikate të lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-

MED duhet t'i mbajë dokumentet e përmendura në nenin 17(3) për të paktën tre vjet.

2. Eksportuesi që bën një deklaratë origjine duhet të mbajë për të paktën tre vjet një kopje të kësaj deklarate, si dhe dokumentet e përmendura në nenin 21(3).

3. Autoritetet doganore të vendit eksportues që lëshojnë certifikatën e lëvizjes së mallrave EUR.1 duhet të mbajnë për të paktën tre vjet formularin e aplikimit të përmendur në nenin 17(2).

4. Autoritetet doganore të vendit importues mbajnë për të paktën tre vjet certifikatën e lëvizjes të mallrave EUR.1 dhe EUR-MED, si dhe deklaratën e origjinës që iu paraqiten atyre.

Neni 30

Mospërputhjet dhe gabimet formale

1. Në rast se gjenden mospërputhje të vogla në deklaratimet e bëra në provën e origjinës dhe ato të bëra në dokumentet e paraqitura në zyrën doganore për qëllime të kryerjes së formaliteteve për importimin e produkteve, kjo nuk sjell pavlefshmërinë *ipso facto* të provës së origjinës nëse vërtetohet se ky dokument i korrespondon produkteve të paraqitura.

2. Gabimet formale të dukshme, të tilla si gabime gjatë shtypjes në provën e origjinës nuk bëhen shkas për anulimin e këtij dokumenti, nëse këto gabime nuk janë të tilla që të krijojnë dyshime në lidhje me korrektësinë e deklaratimit të bërë në këtë dokument.

Neni 31

Shumat e shprehura në euro

1. Në zbatim të dispozitave të nenit 22(1)(b) dhe nenit 27(3) në rastet kur produktet faturohen në një monedhë tjetër veç euros, shumat në monedhën kombëtare të shteteve të përmendura në nenin 3 dhe nenin 4, ekuivalente me shumat e shprehura në euro, duhet të fiksohet çdo vit nga secila Palë.

2. Një dërgesë malli përfiton nga dispozitat e nenit 22(1)(b) dhe nenit 27(3), duke iu referuar monedhës në të cilën është përgatitur fatura, sipas shumës së fiksuar nga Palët përkatëse.

3. Shumat që do të përdoren në çdo lloj monedhë kombëtare duhet të jenë të barasvlershme të kësaj monedhe me shumën e shprehur në euro në ditën e parë të punës së muajit



tetor dhe aplikohen nga 1 janari i vitit pasues. Palët njoftojnë Shqipërinë mbi shumat përkatëse.

4. Pala mund të rrumbullakosë më lart ose më poshtë shumën e përftuar nga konvertimi në monedhën e vet kombëtare të një shume të shprehur në euro. Shuma e rrumbullakosur nuk duhet të ndryshojë nga shuma që rrjedh prej konvertimit me më shumë se 5%. Një vend mund të mbajë të pandryshuar ekuivalentin e monedhës kombëtare të një shume të shprehur në euro, në rast se gjatë kohës së rakordimeve vjetore, sipas paragrafit 3, konvertimi i kësaj shume, përpara rrumbullakosjes, rezulton me një rritje më pak se 15% në ekuivalentin e monedhës kombëtare. Ekuivalenti në monedhën kombëtare mund të mbahet i pandryshuar në rast se konvertimi çon në pakësimin e kësaj vlere ekuivalente.

5. Shumat e shprehura në euro rishikohen nga Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit me kërkesë të cilësdo palë. Kur të kryejë këtë rishikim, Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit merr parasysh dëshirën për t'u mbrojtur nga pasojat e efekteve të kufizimeve në terma realë. Për këtë qëllim, ai mund të vendosë të modifikojë shumat e shprehura në euro.

TITULLI VI MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIMIN ADMINISTRATIV

Neni 32

Ndihma e ndërsjellë, bashkëpunimi administrativ

1. Autoritetet doganore të Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar u sigurojnë njëra-tjetres kopje të specimenit të vulave të përdorura në zyrat e tyre doganore për lëshimin e certifikatave të lëvizjes së mallrave EUR.1 dhe EUR-MED dhe adresat e autoriteteve përgjegjëse doganore për të vërtetuar këto certifikata dhe deklarata origjine.

2. Me qëllim sigurimin e aplikimit të duhur të këtij protokoll, Mbretëria e Bashkuar dhe Shqipëria duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën, përmes administratave doganore përgjegjëse, për kontrollin e origjinalitetit të certifikatave të lëvizjes së mallrave EUR.1 dhe EUR-MED, deklaratave të origjinës, si dhe korrektësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

Neni 33

Verifikimi i provave të origjinës

1. Verifikimet pasuese të provave të origjinës kryhen me metodën rastësore, ose sa herë që autoritetet doganore të vendit importues kanë dyshime të arsyeshme për origjinalitetin e dokumenteve të tilla, për statusin e origjinës së produkteve përkatëse ose për përmbushjen e kërkesave të tjera të këtij protokoll.

2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të Palës importuese ia kthejnë certifikatën e lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED, si dhe deklaratën e origjinës, në rast se është paraqitur, ose një kopje të këtyre dokumenteve, autoriteteve doganore të vendit eksportues, duke u dhënë, atëherë kur është e nevojshme, arsyet për kërkesën për verifikim. Çdo dokument dhe informacion i marrë, i cili sugjeron se informacioni i dhënë mbi provën e origjinës është jokorrekt, bashkëngjitet në mbështetje të kërkesës për verifikim.

3. Verifikimi kryhet nga autoritetet doganore të vendit eksportues. Për këtë qëllim, ato kanë të drejtën të kërkojnë çdo dokument dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të eksportuesit ose çdo lloj kontrolli që konsiderohet i nevojshëm.

4. Në rast se autoritetet doganore të Palës importuese vendosin të pezullojnë përkohësisht dhënien e trajtimit preferencial për produktet përkatëse, ndërkohë që presin rezultatet e verifikimit, importuesit i ofrohet mundësia për të mos i bllokuar produktet, me kusht të përmbushjes së masave paraprake kur gjykohet e nevojshme.

5. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin informohen për rezultatet e këtij verifikimi, sa më shpejt të jetë e mundur. Këto rezultate duhet të tregojnë qartë kur dokumentet janë origjinale dhe kur produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte origjinuese në Mbretërinë e Bashkuar, në Shqipëri ose në ndonjë prej shteteve të përmendura në nenin 3 dhe nenin 4 dhe që përmbushin kërkesat e tjera të këtij protokoll.

6. Në rast se për një dyshim të arsyeshëm, nuk ka përgjigje brenda dhjetë muajve nga data e kërkesës për verifikim, ose në qoftë se përgjigja nuk përmban informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar origjinalitetin e dokumentit në fjalë ose origjinën e vërtetë të produkteve, autoritetet doganore kërkuar të hetimit, me përjashtim të



rrethanave të jashtëzakonshme, refuzojnë dhënien e trajtimit preferencial.

Neni 34

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kur ka mosmarrëveshje lidhur me verifikimin e procedurave të nenit 32, të cilat nuk mund të zgjidhen mes autoriteteve doganore që kërkojnë verifikimin dhe autoriteteve doganore përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi, ato i paraqiten Këshillit të Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit.

Në të gjitha rastet, zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet importuesit dhe autoriteteve doganore të vendit importues do të bëhet sipas legjislacionit të vendit importues.

Neni 35

Gjobat

Gjobat aplikohen mbi çdo person që fsheh ose shkakton fshehjen e një dokumenti që përmban informacion jokorrekt për qëllimin e marrjes së trajtimit preferencial për produktet.

Neni 36

Zonat e lira

1. Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që produktet e tregtuara që janë objekt i provës së origjinës, dhe që gjatë transportit përdorin një zonë të lirë që është në territorin e tyre, të mos zëvendësohen nga mallra të tjera dhe të mos pësojnë përpunim tjetër veç veprimeve normale që parandalojnë përkeqësimin e gjendjes së mallrave.

2. Në kuptimin e derogimit nga dispozitat që përmban paragrafi 1, kur produktet origjinuese në Shqipëri ose Mbretërinë e Bashkuar importohen në një zonë të lirë me një provë origjine dhe pësojnë trajtim ose përpunim, autoritetet përkatëse duhet të lëshojnë një certifikatë të re EUR.1 ose EUR-MED me kërkesë të eksportuesit, në rast se trajtimi dhe përpunimi i pësuar është në përputhje me dispozitat e këtij protokoll.

Neni 37

Derogimet

Produktet e renditura më poshtë përjashtohen nga kumulimi i parashikuar në nenet 3 dhe 4, përveç kumulimit në lidhje me Bashkimin Evropian (parashikuar në paragrafët 1 dhe 3 të nenit 3), nëse:

a) Vendi i destinacionit fundor është Mbretëria e Bashkuar; dhe:

i. materialet e përdorura për prodhimin e këtyre produkteve janë me origjinë nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi, Republika e Serbisë ose Republika e Kosovës; ose

ii. këto produkte e kanë përfituar origjinën e tyre në bazë të punës ose përpunimit të realizuar në cilindo nga vendet e përmendura në paragrafin (a)(i); ose

b) Vendi i destinacionit fundor është Shqipëria; dhe:

i. materialet e përdorura për prodhimin e këtyre produkteve janë me origjinë në Mbretërinë e Bashkuar; ose

ii. këto produkte e kanë përfituar origjinën e tyre mbi bazën e punës ose përpunimit të realizuar në Mbretërinë e Bashkuar.



Kodi NK	Përshkrimi
1704 90 99	Ëmbëlsira të tjera prej sheqeri, të cilat nuk përmbajnë kakao.
1806 10 30	Çokollatat dhe përgatitje të tjera ushqimore që përmbajnë kakao.
1806 10 90	Pluhur kakao, që përmban sheqer apo lëndë të tjera ëmbëlsuese shtesë: - Që përmbajnë sukrozë 65% apo më shumë, por më pak se 80% në raport me peshën (duke përfshirë sheqerin e konvertuar të shprehur si saharozë) apo izoglukoze të shprehur si saharozë; - Që përmbajnë sukrozë 80% apo më shumë në raport me peshën (duke përfshirë sheqerin e konvertuar të shprehur si saharozë) apo izoglukoze të shprehur si saharozë.
1806 20 95	- Përgatitje të tjera në bilok, pllaka apo shufra që përmbajnë kakao dhe peshojnë më shumë se 2 kg, apo që janë në gjendje të lëngët, brumë, pluhuri apo të granular, apo në forma të tjera në tufë, në kontejnerë apo në paketa të çastit, me një përmbajtje më tepër se 2 kg; - Të tjera; - Të tjera.
1901 90 99	Ekstrakt malti; përgatitjet ushqimore prej mielli, kokrrizave, niseshtesë apo ekstraktit të maltit, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë kakao në raport me peshën më pak se 40%, të llogaritur mbi një bazë totalisht të çyndyrosur, të paspecifikuara e të papërfshirë diku tjetër; përgatitjet ushqimore të mallrave të krerëve nr. 0401 deri 0404, që nuk përmbajnë kakao apo që përmbajnë kakao në raport me peshën më pak se 5% të llogaritur mbi një bazë totalisht të çyndyrosur, të papërfshirë dhe të paspecifikuara diku tjetër; - Tjetër; - Tjetër (të ndryshme nga ekstrakti i maltës); - Tjetër.
2101 12 98	Përgatitje të tjera me bazë kafeje.
2101 20 98	Përgatitje të tjera me bazë çaji ose matëse.
2106 90 59	Përgatitje ushqimore të paspecifikuara, ose të papërfshira gjetkë - Të tjera; - Të tjera.
2106 90 98	Përgatitje ushqimore të paspecifikuara, ose të papërfshira gjetkë - Të ndryshme nga koncentratet proteinike dhe substancat proteinike të strukturuar - Të tjera; - Të tjera.
3302 10 29	Përzierjet e substancave aromatike dhe përzierjet (përfshirë solucionet alkoolike) me bazë nga një apo më shumë të këtyre substancave, të një lloji të përdorur si lëndë e parë në industri; preparatet e tjera të bazuara në substancat aromatike, të një lloji të përdorur për prodhimin e pijeve: - të llojit të përdorur në industrinë ushqimore ose të pijeve - të llojit të përdorur në industrinë e pijeve: - Preparatë që përmbajnë të gjithë agjentët aromatizues që e karakterizojnë një pije: - Të një lloji fortësie alkoolike me volum që nuk e tejkalon vlerën 0.5% - Tjetër: - Që nuk përmban yndyrna të qumështit, saharozë, izoglukoze, glukozë apo niseshte apo që përmbajnë, në raport me peshën, më pak se 1,5% yndyrë qumështi, 5% saharozë apo izoglukoze, 5% glukozë apo niseshte; - Tjetër.



TTTULLI VII CEUTA DHE MELILLA

Neni 38 Zbatueshmëria e protokollit

Termi “Bashkimi Evropian”, i përdorur në këtë protokoll, nuk përfshin Ceutën dhe Melillën. Produktet me origjinë nga Ceuta dhe Melilla nuk konsiderohen të jenë produkte me origjinë nga Bashkimi Evropian për qëllimet e këtij protokollit.

TTTULLI VIII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 39 Dispozita tranzitore për mallra në transit ose magazinim

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje mund të zbatohen për mallrat që përputhen me dispozitat e këtij protokollit dhe të cilat, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, janë ose në transit ose janë në Shqipëri ose në Mbretërinë e Bashkuar në magazinim të përkohshëm në doganë, ose në zona të lira, duke iu nënshtruar dorëzimit pranë autoriteteve doganore të vendit importues, brenda dymbëdhjetë muajve nga data e përmendur në certifikatën e lëvizjes së mallrave EUR.1 ose EUR-MED, të lëshuar në mënyrë *aposteriori* nga autoritetet doganore të vendit eksportues së bashku me dokumentet që tregojnë se mallrat janë transportuar drejtpërdrejt në përputhje me parashikimet e nenit 13.

Neni 40 Shtojcat

1. Shtojcat 1 deri IV b të shtojcës 1 të Konventës Rajonale mbi rregullat preferenciale pan-euro-mesdhetare të origjinës përfshihen dhe bëhen pjesë e këtij protokollit si shtojca I deri në shtojcën IVb të këtij protokollit dhe zbatohen, *mutatis mutandis*, duke iu nënshtruar modifikimeve të mëposhtme:

a) Në shtojcën I:

i. të gjitha referencat në “nenin 5 të kësaj shtojce” do të kuptohen si referenca në “nenin 6 të këtij protokollit”; dhe

ii. në paragrafin 3.1 të shënimit 3, “një Palë Kontraktuese” zëvendësohet me “cilindo nga vendet e tjera të përmendura në nenet 3 dhe 4 të këtij protokollit me të cilin zbatohet kumulimi”.

b) Në secilën prej shtojcave IIIa dhe IIIb, referencat për “Palët Kontraktuese” kuptohen si referenca për “Palët”;

c) Në secilën prej shtojcave IVa dhe IVb;

d) Në këtë protokoll do të përfshihen vetëm versionet shqip ose anglisht të deklarates së origjinës; dhe

e) Fjalja e dytë e shënimit 2 nuk do të përfshihet.

2. Shtojcat e këtij protokollit përbëjnë pjesë integrale të tij.

Neni 41 Amendimet e protokollit

Këshilli i Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit mund të vendosë të ndryshojë dispozitat e këtij protokollit.

SHTOJCË A LISTA E PËRMENDUR NË NENIN 3(2) DHE 4(2) TË PROTOKOLLIT 4

i. Republika Demokratike e Popullit e Algjerisë

ii. Republika Arabe e Egjiptit

iii. Shteti i Izraelit

iv. Mbretëria Hashemite e Jordanit

v. Republika e Libanit

vi. Mbretëria e Marokut

vii. Organizata e Çlirimit të Palestinës për të mirën e Autoritetit Palestinez të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës

viii. Republika Arabe Siriane

ix. Republika e Tunizisë

x. Bosnja dhe Hercegovina

xi. Republika e Maqedonisë së Veriut

xii. Mali i Zi

xiii. Republika e Serbisë

xiv. Republika e Kosovës

xv. Mbretëria e Danimarkës në lidhje me Ishujt Faroe

xvi. Republika e Moldavisë

xvii. Gjeorgjia

xviii. Ukraina

SHTOJCË B
DEKLARATË E PËRBASHKËT LIDHUR
ME PRINCIPATËN E ANDORËS

1. Produktet me origjinë nga Principata e Andorës që plotësojnë kushtet e nenit 3(7)(b)(ii) dhe nenit 4(5)(b)(ii) të protokollit 4, dhe që bien nën kapitujt 25 deri 97 të Sistemit të Harmonizuar pranohen nga Palët si me origjinë në Bashkimin Evropian në kuptimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Protokoli 4 zbatohet *mutatis mutandis* me qëllim të përcaktimit të statusit origjinues së produkteve të lartpërmendura.

SHTOJCË C
DEKLARATË E PËRBASHKËT LIDHUR
ME REPUBLIKËN E SAN MARINOS

1. Produktet me origjinë nga Republika e San Marinos, që plotësojnë kushtet e nenit 3(7)(b)(ii) dhe nenit 4(5)(b)(ii) të protokollit 4, pranohen nga palët si me origjinë në Bashkimin Evropian brenda kuptimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Protokoli 4 zbatohet *mutatis mutandis* me qëllim të përcaktimit të statusit origjinues së produkteve të lartpërmendura.

DEKLARATAT E PËRBASHKËTA

Në lidhje me Marrëveshjen e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (“Marrëveshja”), Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar kanë miratuar deklaratat e mëposhtme:

Deklaratë e përbashkët lidhur me qasjen trepalëshe ndaj rregullave të origjinës

1. Në paraprirje të përfundimit të negociatave tregtare ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Mbretërisë së Bashkuar, Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar pranojnë se rezultati i duhur për marrëveshjet tregtare midis Shqipërisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian është qasja trepalëshe ndaj rregullave të origjinës, ku përfshihet Bashkimi Evropian. Kjo qasje do të replikonte mbulimin e flukseve ekzistuese tregtare dhe do të mundësonte njohjen e vazhdueshme të përmbajtjes origjinuese, qoftë nga Shqipëria ose Mbretëria e Bashkuar apo nga Bashkimi Evropian në eksportet ndaj njëra-tjetres, sipas qëllimit të Marrëveshjes së

Stabilizim-Asocimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër. Për këtë, Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar pranojnë faktin se çdo marrëveshje dypalëshe ndërmjet tyre përbën hapin e parë drejt realizimit të këtij rezultati.

2. Në rast se Mbretëria e Bashkuar dhe Bashkimi Evropian, arrijnë një marrëveshje për rregullat e origjinës të përshtatshme për një qasje trepalëshe, Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar pranojnë të ndërmarrin hapat e nevojshëm, sa më shpejt të jetë e mundur, për të përditësuar protokollin 4 të inkuorporuar të Marrëveshjes (përkufizimi i konceptit “produkte origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ) me qëllim që të pasqyrohet qasja trepalëshe ndaj rregullave të origjinës, duke përfshirë Bashkimin Evropian. Hapat e nevojshëm do të merren në përputhje me procedurat e Këshillit të Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit të përfshira në protokollin 4 të kësaj Marrëveshjeje. Nëse, me hyrjen në fuqi, marrëveshja midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Evropian nuk përfshin rregullat e origjinës të përshtatshme për një qasje trepalëshe, të dyja Palët vlerësojnë se një qasje trepalëshe do të vazhdojë të jetë ambicia e përgjithshme.

3. Kjo deklaratë e përbashkët do të hyjë në fuqi me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes dhe do të vazhdojë të funksionojë derisa zgjidhjet me shkrim nga Republika e Shqipërisë ose Mbretëria e Bashkuar. Zgjidhja e Marrëveshjes do të hyjë në fuqi menjëherë me datën marrjes së këtij njoftimi.

Deklaratë e përbashkët për nenet 22 dhe 29 të inkuorporuara

Në zbatim të neneve 22 dhe 29 të inkuorporuara, Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar deklarojnë se do të shqyrtojnë në Këshillin e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit, ndikimin e çdo marrëveshjeje preferenciale të negociuar mes Shqipërisë dhe vendeve të treta.

Ky shqyrtim do të mundësojë rregullimin e koncesioneve mes Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, nëse Shqipëria do të ofronte koncesione shumë më të favorshme ndaj këtyre vendeve të treta.



Deklaratë e përbashkët për emigracionin e ligjshëm, lirinë e lëvizjes dhe të drejtat e punëtorëve

Dhënia, rinovimi apo refuzimi i lejes së qëndrimit rregullohet nga legjislacioni i Mbretërisë së Bashkuar, dhe nga çdo marrëveshje dhe konventë dypalëshe në fuqi ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar.

Sa më sipër përfaqëson marrëveshjet e arritura mes autoriteteve përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për çështjet e përmendura në këtë dokument.

Nënshkruar në dy kopje, në Tiranë, më 3 shkurt 2021 në gjuhën shqipe dhe angleze, ku të dyja tekstet kanë vlefshmëri të njëjtë. Në rast mospërputhjes mes teksteve do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

Për Republikën e Shqipërisë:

Olta Xhaçka
Ministre

Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut:

Duncan Norman
Ambasador

DEKRET

Nr. 12016, datë 11.3.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 31/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM Nr. 140, datë 10.3.2021

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114, të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Toni Gogu, prefekt i Qarkut të Tiranës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Mersin Murataj emërohet prefekt i Qarkut të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM Nr. 142, datë 10.3.2021

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITUESIT NGA PROGRAMI PËR ZHVILLIMIN E ZONËS, ME QËLLIM STREHIMIN, MËNYRËN E SIGURIMIT TË STREHIMIT TË TYRE GJATË PERIUDHËS SË NDËRTIMIT, FORMËN E KALIMIT TË PRONËSISË PËR KUOTA TË PËRCAKTUARA PËR BANESA SOCIALE NGA NDËRTUESIT OSE PRONARËT, PËR STREHIMIN E PËRFITUESVE QË JANË ZHVENDOSUR PREJ TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Ky vendim ka si qëllim përcaktimin e:

a) kriterëve për përfituesit e programit për zhvillimin e zonës, me qëllim strehimin;



b) mënyrës së sigurimit të strehimit të përfituesve gjatë periudhës së ndërtimit të banesave sociale;

c) formës së kalimit të pronësisë për kuotat e banimit të përcaktuara për banesat sociale ose pronarët, me qëllim strehimit të përfituesve që janë zhvendosur prej tyre.

Me termin “kuotë banimi” kuptohet sipërfaqja e ndërtimit e njërive të banimit (në vijim dhe për efekt regjistrimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës do të përdoret termi “njësi banimi”).

2. Zhvillimi i një zone, me qëllim strehimit, realizohet kur truall:

a) i zënë me ndërtime pa leje që nuk mund të legalizohen në përputhje me ligjin për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, me ndërtime pa leje të papërfunduara të identifikuar si të tilla nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ose me ndërtime të vjetra industriale, jofunksionale, të zëna nga individë pa autorizime përkatëse për strehim, është në pronësi të shtetit;

b) i zënë me ndërtime të rregullta, me intensitet të ulët ndërtimi, është në pronësi të subjekteve private, pronarë të banesave. Me “ndërtime të rregullta”, sipas kësaj shkronje, kuptohen ndërtime të realizuara sipas legjislacionit për planifikimin e territorit që ka qenë në fuqi në kohën kur janë realizuar ndërtimet, të cilat kanë përfunduar procesin e legalizimit, ndërtime pa leje që janë në proces legalizimi, si dhe ato që plotësojnë kushtet ligjore për legalizim;

c) është i lirë dhe është në pronësi të shtetit ose të subjekteve private.

3. Truall që përdoret për zbatimin e programit për zhvillimin e zonës, sipas këtij vendimi, vlerësohet nga vlerësues të licencuar të pasurive të paluajtshme, të cilët kontrahohen nga pronarët e truallit. Kjo vlerë negocohet me investitorin, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi me leverdi ekonomike. Në negociatat me investitorin, çdo subjekt, që ka në bashkëpronësi një sipërfaqe truall, përfaqësohet individualisht ose sipas rregullave të administrimit të sendit në bashkëpronësi në përputhje me Kodin Civil.

4. Njësia e vetëqeverisjes vendore, si pronare e truallit, zhvillon zonën vetë apo në marrëveshje me investitorë privatë, sipas procedurave të përcaktuara në përputhje me nenin 52, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

5. Zhvillimi i zonës me qëllim strehimi për ndërtimin e banesave sociale në truall në pronësi të subjekteve private realizohet në marrëveshje ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe pronarëve të truallit. Marrëdhëniet ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe pronarëve të truallit rregullohen sipas rregullave për zhvillimin e detyrueshëm të tokës të ligjit për planifikimin e zhvillimin e territorit.

6. Kontrata e sipërmarrjes, porosisë apo premtim–shitjes ndërmjet investitorit, pronarëve të truallit dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore, që synon kalimin e pronësisë së objektit në ndërtim, regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, në respektim të ligjit “Për kadastrën”.

7. Sipërfaqet e banimit që rezultojnë në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas këtij vendimi, i shtohen fondit të banesave sociale dhe përdoren për strehimit të individëve/familjeve sipas kriterëve të përzgjedhjes të përcaktuara në ligjin për strehimin social.

8. Programi i zhvillimit të zonave për strehim, në rastin kur truall është pronë e shtetit dhe nuk transferohet në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, zbatohet në bashkëpunim ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimit.

9. Truall pronë shtetërore, që përdoret për programet e zhvillimit të zonës me qëllim strehimi, vlerësohet njëjloj si truall privat. Kur truall është në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, ajo zhvillon një procedurë të hapur konkurrimi për të siguruar përqindjen më të lartë të këmbimit të vlerës së truallit me sipërfaqe ndërtimi.

10. Procedura e kalimit të pronësisë së truallit, që ndodhet brenda juridiksionit territorial të njësisë së vetëqeverisjes vendore, realizohet nga kjo njësi. Nëse zona për zhvillim shtrihet në territorin e më shumë se një njësie të vetëqeverisjes vendore, ato lidhin marrëveshje me natyrë koordinimi për realizimin e procedurës për zhvillimin e zonës, ndërtimin e banesave dhe kalimin e pronësisë.

11. Pas përfundimit të procedurës, sipas këtij vendimi, njësia e vetëqeverisjes vendore regjistron marrëveshjen e shkëmbimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, në respektim të ligjit “Për kadastrën”.



II. Kriteret për përfituesit e programit për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi

1. Kriteret për përfituesit dhe kushtet për trajtimin e tyre janë, si më poshtë vijon:

a) Në rastet e shkronjës “a”, të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, fillimisht përfitojnë strehim banorët që ndodhen në zonë. Ndarja e pronësisë mbi sipërfaqen e ndërtimit në objektin që ndërtohet në këtë rast realizohet, si më poshtë vijon:

i. Familjet që banojnë në zonë përfitojnë sipërfaqe ndërtimi sipas normave të strehimit në fuqi;

ii. Kjo sipërfaqe zbritet përpjesëtimisht nga pjesët fituese të sipërfaqes së ndërtimit të ri ndërmjet pronarit të tokës dhe investitorit, të cilët vlerësojnë nëse, pas zbritjes së sipërfaqes së ndërtimit që përfitojnë këto familje, investimi është me leverdi ekonomike për ta ose jo.

b) Në rast zhvillimi të zonës me intensitet të ulët ndërtimi, sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi:

i. fillimisht përfitojnë banorët që banojnë në banesat që ndodhen në zonë dhe janë pronarë të truallit dhe banesës;

ii. sipërfaqja e ndërtimit që i takon investitorit në ndërtimin e ri, edhe kur investitor është njësia e vetëqeverisjes vendore, është e barabartë me diferencën midis sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit dhe sipërfaqes që i takon pronarit sipas marrëveshjes;

iii. në rastet kur investimi realizohet nga subjekte private, njësia e vetëqeverisjes vendore përfiton 3% të sipërfaqes funksionale të ndërtimit mbi 2 000 (dy mijë) m², sipas parashikimeve të ligjit për strehimin social.

c) Në rastin e shkronjës “c”, të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, kur truallit është në pronësi private, përparësi në trajtimin me strehim kanë pronarët e truallit, nëse ata janë në nevojë për strehim. Ndarja e pronësisë në objektin që ndërtohet realizohet sipas kriterëve të përcaktuara në shkronjën “b”, të kësaj pike. Kur truallit i lirë është në pronësi të shtetit, përparësitë përcaktohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas sistemit të pikëzimit dhe kriterëve të përzgjedhjes që përcaktohen në ligjin për strehimin social.

III. Mënyra e sigurimit të strehimit të përfituesve gjatë periudhës së ndërtimit të banesave sociale

1. Gjatë ndërtimit të banesave në zonat që zhvillohen me qëllim strehimi, familjeve/individëve që do të përfitojnë prej tyre, iu sigurohet strehim sipas rregullave të mëposhtme:

a) Nëse investitor është njësia e vetëqeverisjes vendore, kur familjet/individët janë zhvendosur nga ndërtime pa leje të papërfunduara, objekte që nuk mund të legalizohen, si dhe nga objekte të papërshtatshme për banim, njësitë e vetëqeverisjes vendore kujdesen që këto familje, dhe veçanërisht gratë kryefamiljare dhe nëna të vetme, të përfshihen në programin e banesave sociale me qira dhe, kur njësia e vetëqeverisjes vendore nuk disponon banesa sociale me qira, familjet dhe individët e zhvendosur trajtohen me subvencionimin e qirasë në tregun e lirë ose mund të vendosen në strehët e përkohshme;

b) Nëse investitor i zonës që zhvillohet është një subjekt i ndryshëm nga njësia e vetëqeverisjes vendore, familjet, që banojnë në zonat që zhvillohen me qëllim strehimi, sistemohen nga subjekti që investon në banesa të përshtatshme dhe në distanca sa më të afërta me zonën e tyre aktuale të banimit. Shpenzimet për pagesat e qirave ndahen mes investitorit, familjeve dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas marrëveshjes së lidhur. Për familjet pa të ardhura dhe me të ardhura shumë të ulëta, si dhe gratë kryefamiljare e nënat e vetme, qiraja mbulohet tërësisht nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe/ose investitori, sipas marrëveshjes së lidhur;

c) Kur ndërtimi i banesës bëhet mbi truallin nga i cili janë zhvendosur familje/individë që banojnë në ndërtime pa leje të papërfunduara e ndërtime pa leje, që nuk mund të legalizohen, me përparësi trajtohen ato familje, të cilat nuk disponojnë banesë në pronësi, truall për ndërtim apo ndonjë pronë tjetër që mund të përdoret për banim dhe kanë të ardhura jo më të larta se 100% e të ardhurave mesatare familjare të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.



IV. Forma e kalimit të pronësisë për njësitë e përcaktuara për banesat sociale ose pronarët, me qëllim strehimin e përfituesve që janë zhvendosur prej tyre

1. Pas përfundimit të ndërtimit të banesave në zonat që zhvillohen me qëllim strehimin, njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikojnë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për regjistrimin e kontratës që kanë bërë me subjektet financuese të ndërtimit, ku përcaktohen përkatësisht njësitë e banimit që kalojnë në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe në pronësi të subjekteve financuese private apo publike.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, pas kalimit të banesave në pronësi të tyre, për rastet kur ka familje/individë që përfitojnë sipas parashikimeve të këtij vendimi, lidhin marrëveshjen e përfitimit me akt noterial, për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi banesat dhe trojet me familjet/individët përfitues. Një kopje e marrëveshjes dërgohet për regjistrim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

3. Në rastin kur ndërtimi i banesës bëhet me të ardhurat e familjes/individit përfitues, njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhin me akt noterial kontratën për ofrimin pa shpërblim të truallit të pajisur me infrastrukturë, pjesë e zhvillimit të një zone me qëllim strehimin, sipas planit të detajuar vendor, tipologjisë së banesës, kushteve dhe kriterëve të parashikuara me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kontrata lidhet pas miratimit me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore të listës së familjeve/individëve që mbulojnë vetë shpenzimet e ndërtimit të banesës. Kontrata e lidhur me familjet/individët përfitues regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

4. Në rastin kur ndërtimi i banesës bëhet mbi truallin nga i cili janë zhvendosur familje/individë që banojnë në objekte të papërfunduara e objekte joformale, që nuk mund të legalizohen, njësia e banimit të tyre përcaktohet paraprakisht para se të fillojë ndërtimi, në një kontratë paraprake të lidhur me akt noterial ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe subjektit financues privat ose publik, si dhe palëve përfituese nga zhvendosja. Kjo kontratë regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Me mbarimin e ndërtimit, njërive të vetëqeverisjes vendore i kalon pronësia e njërive të

banimit nëpërmjet kontratës së dhurimit, sipas përcaktimeve në kontratën e lidhur.

V. Dispozita të fundit

Ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 146, datë 10.3.2021

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN, DHE FUNKSIONIMIN E MUZEUT TË ARSIMIT KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 214, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Muzeut të Arsimit Korçë.

2. Muzeu i Arsimit Korçë është person juridik publik, buxhetor, i cili ushtron veprimtarinë si një muze qendror i specializuar në fushën muzeore, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Korçë.

3. Muzeu i Arsimit Korçë ka për mision promovimin e trashëgimisë historike dhe kulturore të lidhura me historinë e themelimit të institucionit të parë arsimor në Shqipëri nëpërmjet kontributit të personaliteteve të shquara në Shqipëri e kontributet e diasporës shqiptare të kohës.

4. Burimet e financimit të Muzeut të Arsimit Korçë janë, si më poshtë vijon:

a) buxheti i shtetit;

b) burime të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË MUZEUT TË ARSIMIT KORÇË

Muzeu i Arsimit Korçë ka këto përgjegjësi:

a) të organizojë punën për ekspozimin, pasurimin, propagandimin, studimin dhe mbrojtjen



e vlerave të trashëgimisë kulturore të lidhura me themelimin e institucionit të parë arsimor në Shqipëri;

b) të organizojë punën për përmirësimin dhe pasurimin e mëtejshëm të ekspozimit, duke hulumtuar fondin e pasur muzeor të arsimit në vend.

c) të ofrojë shërbime për publikun në funksion të përmbushjes së përgjegjësiwe funksionale të tij.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I MUZEUT TË ARSIMIT KORÇË

1. Muzeu i Arsimit Korçë organizohet në nivel qendror.

2. Muzeu i Arsimit Korçë funksionon në bazë të ligjit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë, të këtij vendimi, të statutit e të rregullores së tij.

3. Muzeu i Arsimit Korçë e realizon veprimtarinë e tij në bashkëpunim me:

a) organet e administratës shtetërore qendrore dhe organet e vetëqeverisjes vendore;

b) rrjetin muzeor shqiptar;

c) muzetë kombëtarë, muzetë tipologjikë, muzetë vendorë, muzetë privatë, për të tërhequr në fondet e tij objekte me vlera të veçanta, si dhe për ekspozita e aktivitete të tjera të përbashkëta;

ç) institucione shkencore, kulturore, artistike dhe fetare, individë, persona fizikë e juridikë, privatë, për evidentimin, grumbullimin e restaurimin e objekteve, pjesë e fondit të tij, që janë vlera materiale të trashëgimisë kulturore;

d) institucione të huaja simotra nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare, duke marrë në çdo rast miratimin e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

4. Struktura dhe organika e Muzeut të Arsimit Korçë miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

5. Statuti dhe rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës së Muzeut të Arsimit Korçë miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

6. Marrëdhëniet juridike të punës së drejtorit, nëpunësve dhe të punonjësve të Muzeut të Arsimit Korçë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

7. Muzeu i Arsimit Korçë kryen këto detyra:

a) zbaton politikën e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në fushën e trashëgimisë

kulturore materiale dhe jomateriale, në fushën e ekspozimit, pasurimit, propagandimit, studimit, mbrojtjes, konservimit dhe restaurimit të vlerave të trashëgimisë kulturore në fushën e arsimit;

b) ruan dhe studion provat materiale e jomateriale të trashëgimisë historike e kulturore të Shqipërisë, të cilat i komunikon dhe i paraqet në një mjedis që nxit edukimin e argëtimin;

c) siguron disponueshmërinë e koleksioneve të muzeut për vizitorët dhe studiuesit;

ç) bashkëpunon me subjektet arsimore, duke u ofruar personave të të gjitha moshave mundësi për të mësuar nëpërmjet kontaktit me materiale origjinale;

d) organizon aktivitete, të cilat përmbushin vizionin dhe misionin e tij në promovimin historik të institucionit të parë arsimor në Shqipëri;

dh) organizon brenda dhe jashtë vendit çeljen e ekspozitave me objektet që disponon, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) përgatit pasaportën shkencore të çdo objekti ekzistues apo të ri, që bëhet pjesë e fondit të tij, dhe ia përcjell për regjistrim Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;

ë) kryen hulumtime profesionale e shkencore për mbledhjen, vlerësimin, dhe ekspozimin e objekteve që disponon;

f) nxit dhe inkurajon, nëpërmjet projekteve, veprimtarinë kërkimore-shkencore lidhur me fondet që administron për studiuesit në fushën e historisë, edukimit dhe punonjësve në fushën e muzeologjisë;

g) inkurajon dialogun me dhe ndërmjet qytetarëve për të kaluarën, të tashmen e të ardhmen shqiptare.

8. Muzeu i Arsimit Korçë drejtohet nga drejtori i muzeut, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e institucionit e përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

9. Drejtori i Muzeut të Arsimit Korçë emërohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore për një mandat trevjeçar, sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Muzeve. Procedura e përzgjedhjes së drejtorit kryhet nëpërmjet konkursit publik, të realizuar nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe sipas përcaktimeve në rregulloren për metodat e brendshme të punës së muzeut.

10. Drejtori i Muzeut të Arsimit Korçë ka këto kompetenca:



a) drejton veprimtarinë e Muzeut të Arsimit Korçë në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin e institucionit dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të tij;

b) përfaqëson Muzeun e Arsimit Korçë në marrëdhëniet me të tretët;

c) ka të drejtë të lidhë marrëveshje për shkëmbimin e fondeve muzeore, pas marrjes së miratimit nga Këshilli Kombëtar i Muzeve. Procedura e ndjekur në këtë rast bëhet sipas përcaktimeve në ligjin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë;

ç) merr masa mbrojtëse dhe ruajtjeje lidhur me Fondin Kombëtar të Muzeut;

d) emëron e liron nga detyra, në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës, të gjithë punonjësit e muzeut;

dh) nxjerr urdhra dhe udhëzime me karakter të brendshëm për punonjësit e Muzeut të Arsimit Korçë;

e) çdo kompetencë tjetër në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

11. Muzeu i Arsimit Korçë ka stemën dhe vulën e tij zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Muzeu i Arsimit Korçë”, sipas legjislacionit në fuqi.

12. Vula e Muzeut të Arsimit Korçë ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri më 1.1.2022, datë në të cilën fillon funksionimi i plotë i Muzeut të Arsimit Korçë si institucion më vete, misioni, përgjegjësitë dhe detyrat e këtij muzeu do të vijnë të përmbushen nga Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar.

2. Vendimi nr.13, datë 13.1.1997, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e Muzeut të Arsimit në Korçë muze kombëtar”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Kulturës dhe Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM Nr.168, datë 17.3.2021

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKIVE VORË DHE SHIJAK TË OBJEKTEVE ARSIMORE, KOPSHTI “MUÇAJ”, BASHKIA VORË, KOPSHTI NR.1 DHE SHKOLLA E MESME “16 SHTATORI”, BASHKIA SHIJAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkive Vorë dhe Shijak, përkatësisht, të objekteve arsimore kopshti “Muçaj”, Bashkia Vorë, kopshti nr.1 dhe shkolla e mesme “16 Shtatori”, Bashkia Shijak, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Vorë e Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Nr.	Bashkia	Njesia Administrative	Niveli	Emertimi	Tipologjia e Nderhyrjes	Financimi i Nderimit	Siperfaqe (m ²)	Vlera e Projekt Idese	Vle e projektit te zbatimit dhe ndertimit	Vlera e Mbikeqerresit	Vlera e koaludimit	Vlera totale e objektit
19	Shijak	Shijak	e mesme	Gjimnazi 16 Shtatori	Ndertim	Buxhet GoA	2,400.0	838,420.45	80,880,000.00	848,302.26	98,146.50	82,664,869.21
20	Shijak	Shijak	kopesht	Nr. 1	Ndertim	Buxhet GoA	1,160.0	405,236.55	39,092,000.00	410,012.76	47,437.48	39,954,686.78
36	Vore	Mucaj	kopesht	Mucaj	Ndertim	Buxhet GoA	516.0	75,726.67	17,389,200.00	182,384.99	21,101.50	17,668,413.15
TOTAL							4,076.0	1,319,383.7	137,361,200.0	1,440,700.0	166,685.5	140,287,969.1



VENDIM
Nr.169, datë 17.3.2021

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE
TË ISH-REPARTIT “RENEA”,
DREJTORIA E FORCËS SË POSAÇME
OPERACIONALE, LINZË, BASHKIA
TIRANË, DHE CAKTIMIN E
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
POLICISË SË SHTETIT SI NJËSI
ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të objekteve të ish-repartit “Renea”, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Linzë, Bashkia Tiranë, në masën 263 752 795 (dyqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

2. Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i shtohet fondi në masën 131 876 397 (njëqind e tridhjetë e një milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Caktimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si njësi zbatuese për rikonstruksionin e objekteve të ish-repartit “Renea”, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Linzë, Bashkia Tiranë.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 170, datë 17.3.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.7, DATË 6.1.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KUSHTET DHE
PROCEDURËN PËR SHPRONËSIMET
DHE/OSE SHKËMBIMIN E PRONËS,
PËR INTERES PUBLIK, NË FUNKSION
TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 32, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 6, e kreut II, të vendimit nr.7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Prona private, njësi tregtimi:

a) pronarët privatë, që kanë në pronësi njësi tregtimi në zonën e re për zhvillim, kompensohen me vlerë në masën që përlllogaritet nga komisioni i shpronësimit, duke iu referuar çmimeve që zbatohen në procedurat për shpronësimin, për interes publik, sipas legjislacionit në fuqi; ose

b) me pëlqimin e tyre, pronarët privatë që kanë në pronësi njësi tregtimi në zonën e re për zhvillim, kompensohen nëpërmjet shkëmbimit të Së drejtës së pronësisë mbi njësinë e tregtimit me fitimin e pronësisë mbi një njësi banimi ose njësi tregtimi, nëse ka, me të njëjtën sipërfaqe në metër katror sa njësia e tregtimit që kishin në pronësi;

c) në rast se, për shkak të strukturës së njësisë së tregtimit, njësisë së banimit ose shtëpisë individuale të banimit në zonën e re, rezultojnë sipërfaqe shtesë në pronën me të cilën kompensohet, pronari



privat paguan për çdo metër katror shtesë çmimin e miratuar me vendim nga Enti Kombëtar i Banesave në fuqi në kohën e shpronësimit ose të shkëmbimit. Në rast se, për shkak të strukturës së njësisë së tregtimit, njësisë së banimit ose shtëpisë individuale të banimit në zonën e re rezultojnë sipërfaqe më të vogla, në pronën me të cilën kompensohet, pronari privat ka të drejtë të kompensohet, për pjesën e mbetur të sipërfaqes, në përputhje me shkronjën “a”, të kësaj pike.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Rindërtimin, njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësitë zbatuese dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 54, datë 22.2.2021

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË GERTI SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, të nenit 5, pika 1, germa “e” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/3 prot., datë 16.2.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 11, datë 20.1.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Në vijim të kësaj vendimmarrjeje me “Njoftimin për licencim” nr. 6/6 prot., datë 20.1.2021, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankese nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Gerti” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 264 prot., datë 1.2.2021, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe i komunikoi detyrimin për plotësimin e dokumentacionit të munguar të pasqyruar në vendimin e fillimit të procedurës.

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., në përgjigje të sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 264/1 prot., datë 10.2.2021 dhe atë nr. 5/1 prot., datë 11.2.2021, ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën përfundimtare të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Gerti” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germat: “a”, “b”, “c”, plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Gerti” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 55, datë 22.2.2021

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ARIS ALBANIA SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC “GURI I ZI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1719 kw, HEC “DAZNJANË” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 kw, DHE HEC “SHËLLI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1518 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 4755 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a”, dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/8 prot., datë 21.2.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Aris

Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 31, datë 4.2.2021, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Guri i Zi” me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC “Daznjanë” me kapacitet të instaluar 1518 kw, dhe HEC “Shëlli” me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me “Njoftimin për licencim” nr. 6/7 prot., datë 4.2.2021, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Aris Albania” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 109/1 prot., datë 12.2.2021, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe me qëllim marrjen e një vendimi final nga ana e ERE-s për këtë aplikim, bëri me dije nevojën e depozitimit në ERE të dokumentacionit të konstatuar i munguar, apo plotësuar pjesërisht sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 31/2021.

- Shoqëria “Aris Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 109/2 prot., datë 16.2.2021, ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë prodhimi nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën përfundimtare të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Aris Albania” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, plotësuar;



- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, dhe pika 4.1.4, germat: “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat: “a”, “b”, “c”, plotësuar.

- Në përfundim të afatit të lejeve të shfrytëzimit të burimit ujqor (data e përfundimit 27.4.2022), me nr. 99 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Daznjanë”; nr. 100 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Guri i Zi” dhe nr. 101 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Shëlli”, do t’i kërkohet shoqërisë që t’i paraqesë në ERE me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.

-Në përfundim të afatit të kontratave respektive të qirasë me Bashkinë Mat (data e përfundimit 16.7.2021), do t’i kërkohet shoqërisë t’i paraqesë në ERE me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

-Kontrata nr. 2638 rep., nr. 1242/3 kol., datë 24.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Guri i Zi’, me kapacitet prodhues 1719 kw, në pjesën e sipërme të lumit të Kurvajtit dhe në degët e tij, Bashkia Mat, qarku Dibër”; kontrata nr. 2639 rep., nr. 1243 kol., datë 24.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Daznjanë’, me kapacitet prodhues 1518 kw, në përroin e Daznjanës, i cili derdhet në lumin e Kurvajtit, ky i fundit me derdhje në liqenin artificial të Ulzës, Bashkia Mat, qarku Dibër”; kontrata nr. 2440 rep., nr. 1244/3 kol., datë 24.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Shëlli’, me kapacitet prodhues 1518 kw në përroin e grykës së Shëllit, i cili derdhet në lumin e Kurvajtit, ky i fundit me derdhje në liqenin artificial të Ulzës, Bashkia Mat, qarku Dibër”, të lidhura midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe mbajtësit të miratimit, shoqërisë “Aris Albania” sh.p.k., kane një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë

për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Aris Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Guri i Zi” me kapacitet të instaluar 1719 kw, HEC “Daznjanë” me kapacitet të instaluar 1518 kw, dhe HEC “Shëlli” me kapacitet të instaluar 1518 kw, me kapacitet total të instaluar 4755 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Në përfundim të afatit të lejeve të shfrytëzimit të burimit ujqor (data e përfundimit 27.4.2022), me nr. 99 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Daznjanë”; nr. 100 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Guri i Zi” dhe nr. 101 prot., datë 8.5.2017, për HEC “Shëlli”, shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. t’i paraqesë në ERE me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.

3. Në përfundim të afatit të kontratave respektive të qirasë me Bashkinë Mat (data e përfundimit 16.7.2021), shoqëria “Aris Albania” sh.p.k. t’i paraqesë në ERE me afate të rinovuara, jo më vonë se 1 muaj nga nënshkrimi i rinovimit.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 56, datë 22.2.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “REI –
ENERGJI” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, NGA HEC “LINGJACA 1”
ME KAPACITET TË INSTALUAR 1897
kw, HEC “LINGJACA 2” ME KAPACITET
TË INSTALUAR 300 kw, ME KAPACITET
TOTAL TË INSTALUAR 2197 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a”, të nenit 10, pika 3 dhe të nenit 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/1 prot., datë 16.2.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Rei - Energji” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Rei - Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 292 prot., datë 9.2.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Lingjaca 1 dhe 2” me kapacitet të instaluar 2197 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit të Lingjancës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë prodhimi nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë

e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Rei - Energji” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “f”, “g”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “b”, “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat 4.1.3, germat: “a”, “b”, “c” “d”, dhe pika 4.1.4, germat: “b”, “d”, “e”, plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat: “a”, “b”, plotësuar.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, apo dokumentacionit të paraqitur jo në formën e parashikuar nga rregullorja, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “c” (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka përcjellë në ERE ekstraktin historik të QKB-së, datë 16.5.2020 dhe certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së, me datë regjistrimi 18.4.2012, të cilat mbajnë vulën elektronike të institucionit që i lëshon ato. Në vijim, shoqëria duhet të përcjellë në ERE ekstraktin historik të QKB-së me data të rifreskuara, në zbatim të nenit 8, pika 3, të “Rregullores së licencimit”;

- germa “d” (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). Plotësuar pjesërisht. Në vijim, shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës së qarkut Elbasan me data të rifreskuara, në zbatim të nenit 8, pika 3, të “Rregullores së licencimit”;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik). Pa plotësuar. Shoqëria në vijim duhet të depozitojë sa kërkon kjo pikë e rregullores.



- Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- neni 9, pika 3, germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore me datë të rinovuar, në zbatim të nenit 8, pika 3, të “Rregullores së licencimit” dhe po ashtu duhet të depozitojë edhe vërtetimin për detyrimet ndaj tatim-taksave;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.). Pa plotësuar. Shoqëria në vijim duhet të përcjellë në ERE dokumentacionin që kërkohet nga kjo pikë e rregullores.

- Dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1. Të dhëna teknike për HEC “Lingjanca 1” dhe “Lingjanca 2”. Plotësuar pjesërisht.

- Në vijim, shoqëria do të përcjellë në ERE, të plotësuar në formatin e të dhënave teknike, “Datën e fillimit të operimit”.

- Neni 9, pika 4.1.2. Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin. Plotësuar pjesërisht. Në vijim shoqëria do të përcjellë në ERE, të plotësuar në formatin e të dhënave teknike, “Prodhuesin e transformatorit dhe skemën e lidhjes së përshtjellave”.

- Neni 9, pika 4.1.4. Dokumentacioni tekniko-ekonomik:

- germa a, studimi i fizibilitetit. Pa plotësuar. Shoqëria në vijim, duhet të saktësojë dokumentin “Studim fizibiliteti” në lidhje me emërtesën e tij për HEC “Lingjanca 1” dhe “Lingjanca 2”;

- lejet nga institucionet e tjera, neni 9 pika 4.1.5, germa c. Leja mjedisore. Pa plotësuar. Në vijim, shoqëria do të depozitojë në ERE lejen mjedisore, duke qenë se kjo leje mungon në aplikim dhe në vend të saj është depozituar një raport vlerësimi i ndikimit në mjedis, i hartuar nga eksperti i mjedisit për llogari të shoqërisë “Rei - Energji” sh.p.k., do të njoftohet shoqëria që t’i paraqesë ato brenda afateve.

- Në aspektin e përgjithshëm, në këtë aplikim është konstatuar se emërtimi i HEC në disa dokumente është pasqyruar si: “Lingjanca 1 dhe Lingjanca 2” dhe në disa të tjerë “Lingjanca 1 dhe Lingjanca 2”. Në vijim, do t’i kërkohet shoqërisë

saktësimi i emrit të HEC në mënyrë që ERE në vendimmarrjen e saj të shprehet në mënyrë korrekte, duke qenë se edhe në kontratat me MIE-n kjo emërtesë është shprehur në të dy format e sipërcituara.

- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë e Përrenjasit (data e përfundimit 13.5.2027), do t’i kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit të sipërcituar, do të njoftohet subjekti që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, që t’i paraqesë ato brenda afateve.

- Kontrata nr. 57 rep., nr. 16 kol., date 23.1.2012, “Kontratë e formës BOT ndërtim–operim–transferim, për ndërtimin e hidrocentralit “Lingjanca”, ka një afat 35-vjeçar, por nga ana tjetër ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

- Në rastin konkret konstatohet se kontrata e koncesionit, sipërcituar, është nënshkruar në datën 23.1.2012 (data efektive) dhe si e tillë shoqëria “Rei - Energji” sh.p.k., ka humbur 9 vite nga perioda e koncesionit.

Në nenin 5, “Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës”, pika 2, të “Rregullores së licencimit” përcaktohet se: Për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit të licencimit, bëhet për periudhën e mbetur. Ky rregull vlen edhe për rastet e modifikimit të licencave.

Sa më sipër, nga llogaritja e afateve të humbura të koncesionit, kjo shoqëri duhet të licencohet për një periudhë 25 vjet e 10 muaj (duke llogaritur dhe kohën e shqyrtimit të aplikimit në ERE, deri në vendimin final).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Rei - Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lingjaca 1” me kapacitet të instaluar 1897 kw, HEC “Lingjaca 2” me kapacitet të instaluar 300 kw, me kapacitet total të instaluar 2197 kw, për një afat 25 vjet e 10 muaj.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 57, datë 22.2.2021

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “SEKA HYDROPOWER”
SHPK PËR VENDOSJE HIPOTEKE DHE
BARRË SIGURUESE/PENG, NË FAVOR
TË BANKËS INTESA SANPAOLO BANK
ALBANIA SHA, MBI PASURITË E
PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME
TË KRIJUARA APO QË DO TË
KRIJOHEN NGA SHOQËRIA
KONCESIONARE “SEKA
HYDROPOWER” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16; të nenit 20, pika “a”; të nenit 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 6, të nenit 7 dhe të nenit 8, të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 119, datë 21.7.2016; të pikës 1.3 dhe 1.6, të “Kushteve të licencës”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e

Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/7 prot., datë 22.2.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 244, datë 21.12.2020, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., mbi pasuritë e paluajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u vijua me njoftimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., me shkresën nr. 1329 prot., datë 3.12.2020, në të cilën iu bë me dije edhe detyrimi për plotësimin e dokumentacionit të munguar sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 244/2020.

- Në përgjigje të kërkesës së ERE-s, shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1260/1 prot., datë 28.12.2020 dhe nr. 353 prot., datë 12.2.2021, ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Gjatë procedurës së shqyrtimit të këtij transferimi, në ERE ka mbërritur edhe shkresa e datës 23.1.2021, protokolluar në ERE me nr. 54 prot., datë 25.1.2021, e banorëve të fshatit Gjocaj, Njësia Administrative Derjan, pjesë e Bashkisë Mat, të cilët i janë drejtuar ERE-s me kërkesën për rishikim të vendimit nr. 244, datë 21.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., mbi pasuritë e paluajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k.

- Në lidhje me këtë kërkesë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 49, datë 17.2.2021, vendosi mospranimin e kërkesës së banorëve të fshatit Zall-Gjocaj, Njësia Administrative Derjan, pjesë e Bashkisë Mat, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 244, datë 21.12.2020, si të pambështetur në prova.



- Referuar legjislacionit në fuqi, ERE shprehet me miratim vetëm për kërkesat e të licencuarve në lidhje me shitjen, dhënien me qira, transferimin, hipotekimin, barrë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit, transmetimit, shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Nga analizimi i aplikimit të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në fazën finale, në zbatim të nenit 7, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit” rezulton se dokumentacioni i aplikimit është tërësisht i plotësuar si më poshtë:

- neni 7, “Përbërja e kërkesës për transferim”, pika 1, germa: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”. Plotësuar;

- Subjektet koncesionare të licencuara, të cilat aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar, në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen (konkretisht neni 17, pika 1) për shkak të marrëveshjes së koncesionit e pjesët që transferojnë te përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Organit Shtetëror të Autorizuar (OSHA), në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve, i cili përmes shkresës me nr. 8580/1 prot., datë 22.12.2020, protokolluar në ERE me nr. 1260/1 prot., datë 28.12.2020, ka konfirmuar të drejtën e parashikuar në kontratën e lidhur mes palëve, për vendosje hipoteke dhe barre mbi asetet e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., të krijuara në zbatim të kësaj kontrate, për efekt të kredisë në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a. Plotësuar;

- Kërkesa, informacioni dhe dokumentacioni i bashkëlidhur kërkesës, duhet të jenë të nënshkruara nga personi ose personat e autorizuar nga shoqëria që kanë kompetencën për përfaqësimin e personit mbajtës licence apo të kandidatit të propozuar. Plotësuar;

- Pjesë të dokumentacionit që i licencuari kërkon të mos jenë të hapura për publikim, duhet të specifikohen në kërkesën për transferim, së bashku me arsyet e mos bërjes publike të tyre. Plotësuar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1260, datë 11.12.2020, shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për autorizim për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng, në favor të bankës “Intesa

SanPaolo Bank Albania” sh.a., mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k. ERE, në kuptim të nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 2, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, ka në kompetencë të tij vetëm miratimin e vendosjes së hipotekës dhe barrës sigurues/peng për pasuritë e paluajtshme/fikse.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., mbi asetet fikse të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k., referuar nenit 44, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 58, datë 22.2.2021

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “VARDARI”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1972 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13,



të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, nenit 92, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 30/2 prot., datë 16.2.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 10, datë 20.1.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje me “Njoftimin për licencim” nr. 6/5 prot., datë 20.1.2021, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Gerti” sh.p.k..

- Me shkresën nr. 264 prot., datë 1.2.2021, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe i komunikoi detyrimin për plotësimin e dokumentacionit të munguar të pasqyruar në vendimin e fillimit të procedurës.

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., në përgjigje të sa më sipër me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 264/1 prot., datë 10.2.2021 dhe atë nr. 5/1 prot., datë 11.2.2021, plotësoi dokumentacionin e munguar të aplikimit, por u konstatua se një pjesë e tij është lëshuar nga institucionet respektive në emër të shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe jo në emër të aplikantit për licencë, shoqërisë “Gerti” sh.p.k..

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe

heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrikeP.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën përfundimtare të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Gerti” sh.p.k., rezultoi se subjekti ka plotësuar kërkesat e rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrikeP, si më poshtë, por veçojmë faktin se një pjesë e tyre nuk janë lëshuar në emër të shoqërisë “Gerti” sh.p.k.:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat “a”, “b”, “c”, “d”, 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe 4.1.5, germat “a”, “b”, “c”.

- Shoqëria duhet të përcjellë në ERE finalizimin e heqjes nga fondi pyjor kullësor të sipërfaqes së përcaktuar për zhvillimin e projektit.

- Sa më sipër, në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Librazhd (datë 7.8.2027), do t’i kërkohej shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara, një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.

- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 16.10.2022), do t’i kërkohej shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara, një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

- Kontrata nr. 118 rep., nr. 62/2 kol., datë 24.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Vardari me kapacitet 1.972 mw, në përroin e Vardarit dhe Valit, degë e Përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Mbajtësit të Miratimit shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., të drejtat dhe detyrimet e të cilit i janë transferuar më pas shoqërisë “Gerti” sh.p.k. nëpërmjet amendim kontrate me nr. 1818 rep. dhe nr. 388/2 kol., datë 24.12.2020, “Për kontratën e ndërtimit, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Vardari”, me kapacitet 1.972 mw, në përroin e Vardarit dhe Valit, degë e Përroit të Zallit



të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

- Në nenin 92, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuar, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91 të këtij Kodi.

Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.

- Për shkak të kompleksitetit të problematikës që është hasur në dokumentacionin e depozituar nga shoqëria, ERE vlerëson të zgjasë afatin e vendimmarrjes së Bordit me 30 ditë pune në mënyrë që shoqëria të dokumentojë në ERE kryerjen e transferimit të lejes së ndërtimit nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k te shoqëria “Gerti” sh.p.k., në zbatim të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” dhe transferimin e lejes mjedisore, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k., në zbatim të VKM-së nr. 419, datë 25.6.2014, “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për lejë mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.

- Gjithashtu, sa i përket kontratës së qirasë “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik, ndërtim dhe shfrytëzim HEC-i Vardari” me nr. 5006 prot., datë 8.8.2017, të lidhur midis Bashkisë Librazhd dhe shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe “Marrëveshjes së lidhjes së re”, të nënshkruar midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe OSHEE sh.a. me nr. 11301/2, datë 23.5.2017,

shoqëria duhet të dokumentojë në ERE me palët e zëvendësuar, në kuadër të kalimit të të drejtave dhe detyrimeve që solli amendimi i kontratës nr. 1818 rep. dhe nr. 388/2 kol., datë 24.12.2020.

- Shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin që vërteton transferimin e aseteve nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k., si dhe bilancin e çeljes për veprimtarinë e shfrytëzimit dhe administrimit të hidrocentralit “Vardari”, me kapacitet 1.972 mw.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria “Gerti” sh.p.k., të paraqesë brenda 15 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi:

a) dokumentacionin që vërteton kryerjen e transferimit të lejes së ndërtimit nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k.;

b) dokumentacionin që vërteton kryerjen e transferimit të lejes mjedisore, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k.;

c) kontratën e qirasë të lidhur midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe Bashkisë Librazhd “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik, ndërtim dhe shfrytëzim HEC-i Vardari”, me palën qiramarrëse të zëvendësuar;

d) “Marrëveshjen e lidhjes së re”, të nënshkruar midis shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe OSHEE sh.a. me palën e zëvendësuar;

e) dokumentacionin që vërteton transferimin e aseteve nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “Gerti” sh.p.k., si dhe bilancin e çeljes për veprimtarinë e shfrytëzimit dhe administrimit të hidrocentralit “Vardari”, me kapacitet 1.972 mw.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë